



Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET PARLAMENTARE

23 qershor 2013

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti Përfundimtar



Varshavë
10 tetor 2013

PËRMBAJTJA

| | |
|---------------------------------------------------------------------|-----------|
| I. PËRMBLEDHJE | 1 |
| II. HYRJE DHE FALENDERIME..... | 4 |
| III. KONTEKSTI..... | 5 |
| IV. SISTEMI ZGJEDHOR..... | 5 |
| V. KUADRI LIGJOR | 6 |
| VI. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE | 7 |
| VII. TEKNOLOGJITË E REJA PËR ZGJEDHJET..... | 10 |
| VIII. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE | 10 |
| IX. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE | 12 |
| X. FUSHATA ZGJEDHORE..... | 13 |
| XI. FINANCIMI I FUSHATËS..... | 15 |
| XII. MEDIA | 15 |
| A. MJEDISI I MEDIAS | 15 |
| B. KUADRI LIGJOR | 16 |
| C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAS..... | 18 |
| XIII. ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE | 19 |
| XIV. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE..... | 21 |
| XV. VËZHGESIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË..... | 22 |
| XVI. VOTIMI DHE NUMËRIMI..... | 22 |
| A. DITA E ZGJEDHJEVE | 22 |
| B. NUMËRIMI I VOTAVE | 24 |
| XVII. ZHVILLIMET PASZGJEDHORE..... | 25 |
| A. ZHVILLIMET PASZGJEDHORE | 25 |
| B. ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE PAS ZGJEDHJEVE..... | 26 |
| C. SHPALLJA E REZULTATEVE | 27 |
| XVIII. REKOMANDIME..... | 28 |
| A. REKOMANDIME PRIORITARE | 28 |
| B. REKOMANDIME TË TJERA | 29 |
| SHTOJCË: REZULTATET PËRFUNDIMTARE..... | 32 |
| RRETH OSBE/ODIHR-IT | 34 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PARLAMENTARE
23 QERSHOR 2013

Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të ftesës së Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë drejtuar OSBE-së, Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR) dërgoi më datë 15 maj një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet parlamentare të 23 Qershorit 2013. OSBE/ODIHR vlerësoi përputhjen e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së, me standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Lidhur me vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i bashkoi përpyekjet me delegacionet vëzhguese të Asamblesë Parlamentare (AP) të OSBE-së dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE).

Zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit ishin konkurruese, me pjesëmarrje aktive të shtetasve gjatë gjithë fushatës dhe respekt të mirëfilltë për liritë themelore. Megjithatë, atmosfera e mosbesimit mes dy forcave kryesore politike cenoi klimën zgjedhore dhe vështirësoi administrimin e të gjithë procesit zgjedhor.

Kodi Zgjedhor u ndryshua gjerësisht në korrik 2012, çka përmirësoi në mënyrë të përgjithshme kuadrin zgjedhor. Këto ndryshime morën parasysh një sërë rekomandimesh të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit për Demokraci nëpërmjet Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias). Kuadri ligjor që rregullon zgjedhjet parlamentare përgjithësisht siguron një bazë të shëndoshë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Sugjerohen përmirësime të mëtejshme të disa prej aspekteve kryesore të ligjit. Megjithatë, besimi i publikut në procesin zgjedhor u cenua, pasi nuk u zbatuan plotësisht disa aspekte të tij nga të gjitha palët kryesore të interesuara.

Në mungesë të vendimmarrjes nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për caktimin e numrit të mandateve në katër zona zgjedhore, vendimi i mëpasshëm i parlamentit për këtë çështje vuri në pikëpyetje parimin e procesit të rregullt ligjor dhe barazinë e votës, për shkak të përdorimit të statistikave të vjetra të shpërndarjes së popullsisë. Gjykata Kushtetuese vendosi moskompetencën ndaj një kërkesë që kundërshtonte vendimin e parlamentit.

Gjashtëdhjetë e gjashtë parti politike dhe dy kandidatë të pavarur u regjistruan për të konkurruar në një proces gjerësisht përfshirës që u ofroi zgjedhësve një zgjedhje të mirëfilltë. Shumica e partive politike të regjistruara u bashkuan me njërin nga dy koalicionet zgjedhore të drejtuara nga Partia Demokratike (PD) ose Partia Socialiste (PS).

Përgatitjet teknike për zgjedhjet ishin të përshtatshme, pavarësisht disa mangësive të konstatuara, veçanërisht në mosrespektimin e një sërë afatesh ligjore. Pasi partitë opozitare bojkotuan KQZ-në pas shkarkimit të diskutueshëm të njërit prej anëtarëve të saj, KQZ-ja e zhvilloi pjesën e mbetur të punës pa kuorumin e nevojshëm për të miratuar rregullore dhe për të ndërmarrë vendime kyçe. Edhe përpara se KQZ-ja të funksiononte me një numër të reduktuar anëtarësh, ajo nuk arriti të miratonte rregulloret e nevojshme për zbatimin e Kodit Zgjedhor. Përshtypja se KQZ-ja veprroi në mënyrë politike u përforcua nga vendimi i saj për të ndryshuar përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të

¹ Versioni anglisht është i vetmi version zyrtar i këtij raporti. Versioni në shqip është përkthim jozyrtar.

ulëta duke zëvendësuar të gjithë anëtarët e 89 Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) të emëruar nga partia e dytë më e madhe e opozitës dhe këtij vendimi i mungonte argumentimi i shëndoshë ligjor.

Pati thirrje të vonuara të mbledhjeve dhe një paraqitje të paplotë të vendimeve të KQZ-së në faqen e saj të internetit, në kundërshtim me ligjin. Megjithatë, partitë dhe media u informuan dhe morën pjesë në mbledhjet e KQZ-së, të cilat ishin të hapura për publikun dhe transmetoheshin në internet dhe KQZ-ja ishte plotësisht bashkëpunuese me vëzhguesit ndërkombëtarë.

Kodi Zgjedhor parashikonte që KQZ-ja të vinte në provë dy sisteme të teknologjisë zgjedhore: sistemin elektronik të numërimit dhe sistemin elektronik të verifikimit të zgjedhësve. Megjithatë, KQZ-ja humbi një sërë afatesh ligjore dhe nuk miratoi aktet nënligjore të nevojshme, duke bërë kështu të pamundur zbatimin e suksesshëm të tyre. KQZ-ja i anuloi zyrtarisht të dyja sistemet pilote në javën përpara ditës së zgjedhjeve.

Përgjithësisht, ekzistonte besimi në cilësinë e listave të zgjedhësve, me disa shqetësime të shprehura kryesisht nga partitë më të vogla politike. Rreth 139 kryetarë bashkish dhe komunash u gjobitën për mosrespektimin e plotë të detyrimit të tyre ligjor për të informuar KQZ-në për numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjet e qendrave të votimit.

Klima e fushatës ishte përgjithësisht paqësore, me vetëm pak incidente të dhunshme të izoluara. Kandidatët u angazhuan aktivisht në një fushatë të ethshme, edhe pse numri i debateve të drejtpërdrejta mes kandidatëve apo drejtuesve të partive ishte i kufizuar. Ndonjëherë, akuzat e ndërsjella mes dy partive më të mëdha e largonin vëmendjen nga thelbi i fushatës.

Partitë më të mëdha, me raste, përdorën automjetet publike dhe ndërtesat zyrtare për qëllime fushate, gjë e cila ndalohet me ligj. Një sërë aktiviteteve zyrtare qeveritare u shoqëruan me reklama të fushatës së partisë në pushtet, gjë e cila zbehu kufijtë mes institucioneve shtetërore dhe interesave partiake, duke vënë në pikëpyetje respektimin e paragrafit 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990. Presioni mbi punonjësit e sektorit publik për të bërë fushatë apo për të votuar në një mënyrë të caktuar dhe shkarkimet nga puna të motivuara politikisht, njolloshën fushatën. Akuzat për blerjen e votës u intensifikuan me afrimin e ditës së zgjedhjeve, dhe pati disa arrestime nga policia.

Partitë politike mund të financonin fushatat e tyre zgjedhore me kontribute nga fondet publike, donacione private dhe kredi. Kandidatët e pavarur nuk kishin të drejtë të përfitonin nga fondet publike. Kuadri ligjor nuk ofron transparencë të mjaftueshme në lidhje me raportimin e financimit të fushatës, duke qenë se ai nuk përcakton detyrimin për bërjen publike të financimit para ditës së zgjedhjeve.

Mediat audiovizive përgjithësisht u ofruan partive kryesore politike kohë të mjaftueshme transmetimi, duke u krijuar kështu zgjedhësve mundësinë të informoheshin në lidhje me qendrimet kryesore politike. Megjithatë, pavarësia editoriale u pengua nga ndikimi politik. KQZ-ja miratoi një vendim të diskutueshëm që nënkuptoi vendosjen e detyrimit ndaj mediave për të transmetuar materiale të përgatitura nga subjektet zgjedhore në edicionet e tyre informative, gjë e cila do të cenonte lirinë editoriale. Transmetuesi publik u ofroi partive më të mëdha mbulim të njëjtë në edicionet informative, por kishte një ton më pozitiv kundrejt partisë në pushtet. Mediat e monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk e përmbushën detyrimin për t'u siguruar partive më të vogla sasinë e specifikuar të mbulimit në edicionet informative dhe tejkaluan kufirin e reklamave politike të paguara për dy partitë e mëdha. Krijimi i vonuar i Bordit të Monitorimit të Medias dhe mungesa e kolegjalitetit e reduktoi efikasitetin e tij. KQZ-ja nuk zbatoi në mënyrë efikase rregullimet ligjore në lidhje me median.

Kandidatet gra përfituan mbulim të ulët mediatik që reflekton çështjet e vazhdueshme të pjesëmarrjes së grave në jetën politike. Detyrimi për kuotën gjinore në listat e kandidatëve nuk u përmbush nga PD-ja, PS-ja si dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) në një numër zonash zgjedhore, gjë që çoi në vendosjen e gjobave, megjithëse listat që nuk e zbatonin këtë detyrim u regjistruan. Ndërsa partitë politike e përmbushën detyrimin ligjor për të caktuar të paktën 30 përqind të secilës gjini në përbërjen e KZAZ-ve, por vëzhguesit vunë re se në ditën e zgjedhjeve përfaqësimi i grave në Komisionet e Qendrave të Votimit ishte 14 përqind.

Aktorëve zgjedhorë nuk iu garantuan dhe nuk iu siguruan në mënyrën e duhur mjete juridike efektive dhe proces i rregullt ligjor për zgjidhjen e ankesave lidhur me zgjedhjet. Në raste kyçe, organet gjyqësore refuzuan marrjen në shqyrtim të ankimeve ose tejkalojnë kompetencat e tyre. Në disa raste, Kolegji Zgjedhor mori në mënyrë të pavend përgjegjësitë administrative dhe kompetencat diskrecionale të KQZ-së. Garuesit në zgjedhjet rrallëherë i përdorën mekanizmat e disponueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për shkak të ekzistencës së frymës së mosbesimit në sistemin ligjor dhe kulturës në favor të pazareve politike. Zgjedhësit dhe grupet e shoqërisë civile si rregull nuk u legjitimuan të ankoheshin ndaj vendimeve administrative të komisioneve zgjedhore.

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht paqësore dhe e u zhvillua në mënyrë të rregullt, megjithëse një incident vdekjeprurës në Laç ndikoi negativisht në fillimin e zgjedhjeve. Një numër i konsiderueshëm i qendrave të votimit u hapën me vonesë, kryesisht për shkak të mungesës së organizimit. Raste të votimit familjar/në grup dhe zbatimi në mënyra të ndryshme i disa procedurave ndikuan negativisht në vlerësimin e përgjithshëm të votimit. Procedurat e mbylljes dhe marrja në dorëzim e kutive të votimit në vendet e numërimit të votave (VNV) u vlerësuan me nota më pozitive.

Numërimi u vonua në shumë VNV për shkak të çorganizimit, duke përfshirë edhe emërimin e vonuar të numëruesve dhe pengesat e krijuara nga disa numërues të propozuar nga partia në pushtet. Kur numërimi vijoi, në përgjithësi ishte i rregullt, megjithëse i ngadaltë, dhe u vlerësua pozitivisht. Me disa përjashtime, në përgjithësi KZAZ-të i përpiluan rezultatet në mënyrë të kënaqshme. Prania e vëzhguesve nga shoqëria civile dhe vëzhguesve të partive gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve në përgjithësi e shtoi transparencën, megjithëse në disa raste vëzhguesit e partive u konstatuan duke drejtuar apo ndërhyrë në procesin e votimit ose numërimit.

KQZ-ja filloi t'i pasqyrojë në faqen e internetit rezultatet paraprake në mëngjesin pas zgjedhjeve, edhe pse e miratoi shumicën e rezultateve të zonave zgjedhore në tejkalim të afateve ligjore. KQZ-ja mori rreth 40 ankesa që kundërshtonin rezultatet e një sërë zonash zgjedhore, shumica me pretendimin që kundërshtarët politikë përveçësuan vota gjatë numërimit.

Edhe pse KQZ-ja me përbërjen e saj të reduktuar nuk duhet t'i merrte në shqyrtim ankesat kundër rezultateve, në praktikë ajo e ushtroi këtë kompetencë ligjore. Ndërsa ankesat e paraqitura nga partitë e vogla u refuzuan rregullisht, KQZ-ja pranoi dhe shqyrtoi ankesat e paraqitura nga partitë më të mëdha kundër rezultateve në tre qarqe (Lezhë, Shkodër dhe Kukës), ku kandidatët kryesues ndaheshin nga një diferencë e ngushtë votash. Rinumërimet e kryera me vendim të KQZ-së, në përgjithësi treguan mospërputhje të papërfillshme, që nuk ndikuan në shpërndarjen e mandateve.

Pas zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor pranoi një ankesë që kundërshtonte ligjshmërinë e veprimeve të KQZ-së, me argumentin se seancat e KQZ-së për ankesat kundër rezultateve kërkojnë një kuorum prej pesë anëtarësh. Në vijim, Kolegji Zgjedhor pranoi një sërë kërkesash për të shpallur të pavlefshme për shkaqe procedurale vendimet e KQZ-së mbi ankesat dhe rinumërimet, por gjithashtu urdhëroi rinumërim të qendrave të caktuara të votimit në Kukës dhe Lezhë. Të dyja rinumërimet përgjithësisht

konfirmuan rezultatet e nxjerra dhe gjykata e urdhëroi KQZ-në t'i ndryshojë vendimet e saj në përputhje me këto rezultate.

Më 2 gusht, Kolegji Zgjedhor mori kompetencat e KQZ-së dhe shpërndau mandatet për të 12 qarqet, si pasojë e një ankese kundër mosmarrjes së vendimit nga ana e KQZ-së për shkak të mungesës së kuorumit. Në vijim, më 6 gusht KQZ-ja shpalli rezultatet përfundimtare për zgjedhjet.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Në përgjigje të ftesës së Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë dërguar OSBE-së, Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR-i) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ-në) më datë 15 maj për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare. Drejtuar nga Conny McCormack, misioni përbëhej nga ekipi kryesor me 15 anëtarë, me zyrë në Tiranë dhe nga 30 vëzhgues afatgjatë, të cilët u shpërndanë në të gjithë vendin.

Për vëzhgimin në ditën e zgjedhjeve, OSBE/ODIHR bashkoi përpjekjet me delegacionet nga Asambleja Parlamentare (AP e OSBE-së) dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE). Roberto Batelli u emërua si Koordinator Special nga Kryetari në Detyrë së OSBE-së për të drejtuar misionin e vëzhguesve afatshkurtër për këto zgjedhje. Delegacioni i APKE-së u drejtua nga Luca Volontè; João Soares kryesoi delegacionin e AP të OSBE-së

Në ditën e zgjedhjeve, 387 vëzhgues nga 43 shtete u shpërndanë në terren, ku përfshiheshin 316 vëzhgues nga OSBE/ODIHR-i, si edhe 48 deputetë dhe punonjës nga AP e OSBE-së, dhe 23 vëzhgues nga APKE. Procesi i votimit u vëzhguar në rreth 1,297 nga 5,508 qendra votimi në të gjithë vendin. Numërimi i votave u vëzhguar në 84 nga 89 Vende të Numërimit të Votave (VNV) dhe përpilimi i rezultateve u vëzhguar në 25 VNV-të.

Zgjedhjet u vlerësuan për pajtueshmërinë e tyre me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtarë për zgjedhje demokratike, si dhe legjislacionin vendas. Ky raport përfundimtar vijon pas Deklaratës së Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake të bëra publike në një konferencë shtypi në Tiranë më 24 qershor.² Katër raste zgjedhjesh të pjesshme për përfaqësues vendorë u zhvilluan paralelisht me zgjedhjet parlamentare. OSCE/ODIHR-i i ka ndjekur këto zgjedhje vetëm në masën që ato ndikuan në zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dëshiron të falënderojë autoritetet e Republikës së Shqipërisë për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Kuvendin e Shqipërisë, Gjykatën Kushtetuese, Kolegjin Zgjedhor dhe autoritetet e tjera shtetërore dhe vendore për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Misioni dëshiron gjithashtu t'i shprehë mirënjohjen, përfaqësuesve të partive politike, medias, shoqërisë civile dhe bashkëbiseduesve të tjerë që ndanë pikëpamjet e tyre. Gjithashtu, OSBE/ODIHR dëshiron t'i shprehë vlerësimin e tij Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe përfaqësive diplomatike të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, si dhe organizatave ndërkombëtare të pranishme në Shqipëri për bashkëpunimin e tyre gjatë gjithë misionit.

² Për të gjitha raportet e mëparshme të OSCE/ODIHR-it mbi Shqipërinë shih <http://www.osce.org/odihr/elections/albania>.

III. KONTEKSTI

Zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit u konsideruan gjerësisht si një test i rëndësishëm për zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe aspiratat e saj drejt aderimit në Bashkimin Evropian. Klima politike kishte qenë e tensionuar që nga zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2009 që rezultuan në përfaqësim pothuajse të barabartë të koalicioneve të drejtuara nga Partia Demokratike (PD) nën drejtimin e Kryeministrit Sali Berisha dhe Partia Socialiste (PS) drejtuar nga Edi Rama. Pas zgjedhjeve, PD-ja e krijoi koalicionin qeverisës me Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI), kryesuar nga Ilir Meta.

Në vijim të largimit të LSI-së nga koalicioni qeverisës në mars të vitit 2013, parlamenti shkarkoi anëtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të propozuar nga LSI-ja i cili u zëvendësua nga një përfaqësues i Partisë Republikane (PR), pasi u bë partia e dytë më e madhe e koalicionit qeverisës. Baza ligjore për shkarkimin ishte e diskutueshme dhe u perceptua gjerësisht si e motivuar politikisht.³ Kjo çoi në dorëheqjen e tre anëtarëve të KQZ-së të propozuar nga opozita, emëruar nga PS-ja dhe Partia e të Drejtave të Njeriut (PBDNJ-ja). Parlamenti nuk i miratoi dorëheqjet siç kërkohet nga ligji, sepse PD-ja pretendonte që opozita duhet të propozojë zëvendësimet përpara se parlamenti të mund të vepronte në lidhje me njoftimin e dhënë nga KQZ-ja.⁴ Opozita iu shmang propozimit të zëvendësimeve, duke pretenduar se shkarkimi ishte i paligjshëm. Rrjedhimisht, KQZ-ja funksionoi vetëm me katër anëtarë që nga mesi i muajit prill.

Klima politike u karakterizua nga polarizim i zgjatur ndërmjet PD-së dhe PS-së dhe mosbesimi i partive të tjera kundrejt tyre. Partitë e vogla kundërshtuan sistemin aktual zgjedhor, për të cilin ata pretendonin se favorizon dy partitë e mëdha politike. Shumica dërrmuese e partive politike të regjistruara iu bashkua njërit prej dy koalicioneve për këto zgjedhje: 25 parti ishin në Aleancën për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, të drejtuar nga PD-ja, dhe 37 parti iu bashkuan Aleancës për Shqipërinë Evropiane, të drejtuar nga PS-ja.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR

Të 140 anëtarët e parlamentit një-dhomësh (Kuvendi) zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare sipas sistemit rajonal proporcional, me 12 zona zgjedhore shumë-emërore që u korrespondojnë rajoneve ose qarqeve administrative të vendit. Partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur mund të konkurrojnë në zgjedhje me lista të mbyllura të kandidatëve të paraqitura nga partitë për çdo zonë. Partitë që marrin të paktën tre përqind dhe koalicionet që marrin të paktën pesë përqind të votave të vlefshme në një zonë kualifikohen për ndarjen e mandateve.

Numri i mandateve për çdo zonë shkon nga 4 në 32. Bazuar në statistikat e shpërndarjes së deritanishme të popullsisë paraqitur nga Ministria e Brendshme (MB), KQZ-së i kërkohet të llogarisë numrin e mandateve për zonë dhe t'ia paraqesë atë parlamentit për miratim.⁵ Megjithëse është një

³ Neni 18 i Kodit Zgjedhor paraqet një listë shteruese arsyesh për ndërprerjen para kohe të mandatit të anëtarëve të KQZ-së, ku nuk përfshihet ri-kompozimi i koalicionit qeverisës dhe të opozitës. Megjithëse arsyetimi zyrtar për shkarkimin e anëtarit të KQZ-së në parlament ishte informacion i ri në lidhje me moszgjedhshmërinë e tij për shkak të shkarkimit të mëparshëm nga një detyrë publike, LSI nuk ishte ftuar për të zëvendësuar këtë anëtar, një fakt i cili sugjeron motivim politik për shkak të largimit të LSI-së nga koalicioni qeverisës.

⁴ Neni 18.2 i Kodit Zgjedhor parashikon se parlamenti miraton dorëheqjet pas njoftimit nga ana e KQZ-së, edhe pse nuk parashikon afat; neni 19.3 parashikon se parlamenti zëvendëson anëtarët e rinj brenda 48 orëve nga krijimi i vakancës.

⁵ Sipas nenit 75 të Kodit Zgjedhor, numri i mandateve për çdo zonë caktohet në bazë të numrit të shtetasve dhe çdo mandat përfaqëson afërsisht një numër të njëjtë shtetasish.

përlllogaritje teknike, KQZ-ja, ishte e ndarë politikisht dhe nuk mund të miratonte shpërndarjen e mandateve. Në mungesë të një propozimi nga KQZ-ja, parlamenti e mori vendimin dhe e bëri shpërndarjen e mandateve në bazë të statistikave të popullsisë të vitit 2009 (në vend të atyre të vitit 2013), çka minoi parimet e procesit të rregullt ligjor dhe barazisë së votës.⁶ Kjo është në kundërshtim me paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990, ku Shtetet pjesëmarrëse angazhohen t'u garantojnë shtetasve të tyre të drejtën e votës së barabartë.

Në mënyrë që të garantohet barazia e votës, caktimi i numrit të mandateve për zonat zgjedhore duhet të bazohet në statistikat e fundit mbi shpërndarjen e popullsisë, sikurse përcaktohet me ligj.

V. KUADRI LIGJOR

Përgjithësisht, kuadri ligjor ofron një bazë të shëndoshë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Gjithsesi, besimi i publikut në procesin zgjedhor u cenua, pasi nuk u zbatuan plotësisht disa aspekte të tij nga të gjithë palët kryesore të interesuara.

Zgjedhjet u rregulluan nga një kuadër ligjor i plotë, duke përfshirë kryesisht Kushtetutën, e ndryshuar për herë të fundit në vitin 2008, dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2008, i ndryshuar për herë të fundit në korrik 2012. Kushtetuta garanton të drejtat dhe liritë themelore, duke krijuar në këtë mënyrë bazën e nevojshme për zgjedhjet demokratike. Ligje të tjera të zbatueshme përfshijnë Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Tubimet dhe Kodin Penal.⁷ Kodi i Procedurave Administrative dhe Kodi i Procedurës Civile zbatohen, përkatësisht, për procedimet e komisioneve zgjedhore dhe të gjykatave. Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri përmban dispozita që sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor në organet e administratës zgjedhore dhe në parlament. KQZ-ja dhe Ministria e Brendshme plotësojnë kuadrin ligjor me akte lënligjore dhe vendime.

Në vijim të një procesi të gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi, Kodi Zgjedhor u ndryshua gjerësisht në korrik të vitit 2012 me mbështetjen e partive politike kryesore. Ndryshimet përmirësuan përgjithësisht kuadrin ligjor zgjedhor. Prosesi i reformës kryesisht mori parasysh rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) i Këshillit të Evropës. Ndryshimet adresuan një sërë rekomandimesh, siç janë përmirësimet thelbësore në procesin e përzgjedhjes së komisionerëve, një proces i përmirësuar për hartimin e listës së zgjedhësve, një proces i thjeshtuar për regjistrimin e kandidatëve, si dhe akses të barabartë në media dhe në fondet publike për financimin e fushatës zgjedhore. Kodi Penal u ndryshua në mars 2012 për të krijuar vepra të reja penale zgjedhore dhe për të rritur dënimet për veprat penale zgjedhore ekzistuese. Megjithëse shfuqizimi i dënimeve me burgim për shpifje është hap pozitiv, këto vepra mbeten shkelje penale që mund të ndëshkohen me gjoba të rënda çka nuk është në përputhje me qendrimet zyrtare të organeve të specializuara.⁸

Rekomandohet që dispozitat penale mbi shpifjen të shfuqizohen plotësisht dhe të rregullohen nga legjislacioni civil, në mënyrë që të mos kufizohet padrejtësisht liria e shprehjes.

⁶ Dy mandate duhet të kishin ndryshuar zonat sipas statistikave aktuale të popullsisë: qarku i Beratit dhe ai i Korçës duhet të kishin një mandat më pak secili dhe qarku i Durrësit dhe i Tiranës secili një mandat më tepër.

⁷ Ligji për Partitë Politike rregullon regjistrimin e partive politike nga gjykatat dhe financimin e partive politike; ndryshimet e shkurtit të vitit 2011 përcaktoi kompetencën e KQZ-së për të mbikëqyrur financat e partive politike.

⁸ Shih Deklaratat e Përbashkëta të Reporterit Special për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes të OKB-së, Përfaqësuesin e OSBE-së për Median dhe Reporterin Special për Lirinë e Shprehjes të Organizatës së Shteteve Amerikane më 30 nëntor 2000, 10 dhjetor 2002 dhe 4 shkurt 2010.

Disa rishikime që iu bënë Kodit Zgjedhor e dobësuan kuadrin ligjor, duke përfshirë mekanizma të zbatimit të ligjit më pak të rrepta për mosrespektimin e kuotës gjinore për listat e kandidatëve dhe një dispozitë më të butë për përdorimin e nëpunësve publikë për qëllime fushate.⁹ Gjithashtu u shtua një masë për heqjen e zgjedhësve që kanë mbushur moshën 100-vjeçare automatikisht nga regjistri. Për më tepër, shumë rekomandime të mëparshme mbeten të patrajuara, ku përfshihen masa për të rritur paanshmërinë e komisioneve zgjedhore, të drejtat e kandidatëve të pavarur, transparenca mbi financimin e fushatës, si dhe zgjidhja efektive e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Në përputhje me angazhimet e OSBE-së, ligji parashikon të drejtën e kandidatëve të pavarur për të kandiduar në zgjedhje; megjithatë, ata nuk kanë të drejta të barabarta në procesin zgjedhor.¹⁰

Kuadri ligjor nuk arriti të detajojë një sistem gjithëpërfshirës të sanksioneve për keqpërdorimin e burimeve administrative, duke përfshirë nëpunësit publikë, përfshirjen e nxënësve në fushatë, shpërdorimin e postit zyrtar dhe eventet e qeverisë, për qëllime të fushatës.¹¹ Edhe në rastin kur një nëpunës apo nxënës bën fushatë gjatë orarit të punës në zyrë apo të mësimin, kjo nuk përbën kundërvajtje administrative ose penale, përveç rastit kur personi ishte detyruar të bënte atë.

Rekomandohet që Kodi Zgjedhor të rishikohet për të trajtuar mangësitë e vëna në dukje në këtë raport dhe në raporte të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, duke përfshirë dispozita të cilat sigurojnë të drejta të barabarta për kandidatët e pavarur.

VI. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet u administruan nga një sistem administrimi me tre nivele, të përbërë nga KQZ-ja, 89 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) dhe 5.508 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV-të).¹² KQZ-ja ka shtatë anëtarë, të gjithë të emëruar nga parlamenti. Tre anëtarë propozohen nga shumica parlamentare dhe tre anëtarë nga opozita. Anëtarët e KQZ-së janë me mandat gjashtë-vjeçar, ndërsa kryetari emërohet për një mandat katër-vjeçar nga kandidaturat e paraqitura nga partitë parlamentare pas një procesi të hapur rekrutimi. Dy anëtarë të KQZ-së ishin gra, përfshirë edhe kryetarin.

Pas dorëheqjes së mëpasshme në muajin prill të tre anëtarëve të KQZ-së të emëruar nga opozita, pas shkarkimit të anëtarit të emëruar nga LSI-ja, KQZ-ja funksionoi vetëm me katër anëtarë.¹³ Parlamenti dhe partitë politike nuk arritën të gjejnë një zgjidhje për të zhbllokuar situatën, e cila vështirësoi të gjithë procesin e administrimit zgjedhor dhe aftësinë e KQZ-së për të ushtruar plotësisht autoritetin e saj mbi organet në vartësi.

Mënyra në të cilën operoi KQZ-ja la përshtypjen se ajo po vepronte në mënyrë politike. Ky perceptim u përforcua nga vendimi i KQZ-së për të riformuar komisione zgjedhore të nivelit më të ulët. Pas krijimit fillestar të KZAZ-ve në 25 mars, KQZ-ja zëvendësoi të gjithë anëtarët e emëruar nga partia e dytë më e madhe e opozitës, PBDNJ, në të 89 KZAZ-të me anëtarë të PR, “për shkak të rrethanave të reja të krijuara në përbërjen e grupeve të shumicës dhe opozitës parlamentare”. Ky justifikim nuk përfshihet në listën shteruese të arsyeve ligjore për shkarkim në bazë të nenit 32 të Kodit Zgjedhor.

⁹ Ndalimi i gjerë i parashikuar nga neni 88 mbi “përdorimin” e burimeve njerëzore të shtetit për qëllime fushate gjatë orarit të punës u ndryshua në një ndalim më tolerant të “përdorimit të detyruar” të burimeve njerëzore.

¹⁰ Kodi Zgjedhor nuk u jep të drejtën kandidatëve të pavarur për të emëruar një përfaqësues ligjor në KQZ, të kenë akses të lirë në media, ose të përftojnë financim publik për fushatën.

¹¹ Shih rubrikën mbi Fushatën Zgjedhore.

¹² Për të administruar zgjedhjet, 12 zonat u ndanë në 89 ZAZ, secila administrohej nga një KZAZ.

¹³ Si PS-ja dhe LSI-ja e përdorën të drejtën e tyre ligjore për të emëruar përfaqësues pa të drejtë vote në KQZ dhe përfaqësuesit e tyre morën pjesë aktivisht në mbledhjet e KQZ-së.

Duhet të sigurohet pavarësia institucionale e KQZ-së. Për këtë qëllim, palët e interesuara duhet të veprojnë në përputhje me rolin që kanë në aktivitetet e KQZ-së dhe punonjësit zgjedhorë nuk duhet t'i bazojnë veprimet dhe vendimet e tyre në ndikimin e faktorëve politikë.

KQZ-ja nuk i miratoi të gjitha aktet nënligjore të nevojshme për zhvillimin transparent dhe konsistent të zgjedhjeve dhe as nuk bëri ndryshimet e nevojshme të akteve nënligjore ekzistuese në vijim të ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor.¹⁴ Përbërja e reduktuar e KQZ-së e pengoi rregullimin e aspekteve të procesit zgjedhor në përputhje me ligjin për sa i përket procedurës, meqenëse aktet normative dhe disa vendime kërkonin miratim me një shumicë të cilësuar prej pesë votash.¹⁵ KQZ-ja fillimisht shpërfilli pengesat ligjore në aktivitetet e saj duke miratuar aktet normative me shumicë të thjeshtë në kundërshtim me ligjin¹⁶ si dhe duke shmangur miratimin e vendimeve të domosdoshme për ndryshimin e akteve të vjetëruara.¹⁷ Përkufizimi i aktit normativ në Kodin Zgjedhor ndryshon nga përkufizimi i parashikuar në Ligjin mbi Gjykatat Administrative të vitit 2012.

Një vendim i diskutueshëm i KQZ-së, si në lidhje me procedurën ashtu edhe në lidhje me përmbajtjen, ishte miratimi i rregullave për hedhjen e shortit për përcaktimin e renditjes së kandidatëve në fletën e votimit. Vendimi kërkonte shumicë të cilësuar, por u miratua vetëm me katër vota. Për më tepër, këto rregulla u ndryshuan disa ditë më vonë duke i lejuar KQZ-së të ndryshojë renditjen e partive në fletën e votimit pas hedhjes së shortit, në kundërshtim të nenit 98.3 të Kodit Zgjedhor.¹⁸

Gjithashtu, disa vendime të KQZ-së nuk përfshinin arsyetim ligjor të mjaftueshëm dhe në disa raste KQZ-ja tejkaloi kompetencat e saj rregullatore.¹⁹ Edhe me përbërjen e plotë të saj, KQZ-ja nuk arriti të miratojë aktet nënligjore të nevojshme për të plotësuar Kodin Zgjedhor, duke përfshirë ndarjen e ZAZ-ve dhe rregulloren e procedurave të saj. Në përgjithësi, ishte e vështirë të përcaktoje se cilat aktet nënligjore të KQZ-se ishin në fuqi.

Vëmendje duhet të kushtohet për të sqaruar dispozitat e Kodit Zgjedhor të cilat përkufizojnë aktet normative dhe akte të tjera që duhet të miratohen vetëm me një shumicë të cilësuar, si dhe për të harmonizuar përkufizimet e zbatueshme me Ligjin për Gjykatat Administrative. Gjithashtu, të gjitha aktet nënligjore zgjedhore dhe ndryshimet duhet të miratohen dhe të publikohen në kohë.

Përgatitjet teknike për zgjedhjet ishin të përshtatshme, përveç disa mangësive të evidentuara, veçanërisht mosrespektimi i një numër afatesh ligjore. Pati thirrje të vonuar të mbledhjeve të KQZ-së dhe një paraqitje e paplotë e vendimeve të KQZ-së në faqen e internetit të KQZ-së, në kundërshtim me ligjin.²⁰ Megjithatë, partitë dhe media u informuan dhe morën pjesë në mbledhjet e KQZ-së, të cilat ishin të hapura për publikun dhe transmetoheshin në internet. Gjithashtu, KQZ-ja ishte plotësisht bashkëpunuese me vëzhguesit ndërkombëtarë.

¹⁴ Siç kërkohet nga neni 23.4 i Kodit Zgjedhor.

¹⁵ Shih nenet 24, 61, 62, 94, 95, 98, 101, 103 dhe 179 të Kodit Zgjedhor.

¹⁶ Për shembull, vendimet e KQZ-së nr. 426 datë 17 maj, nr. 445 dhe 446 datë 20 maj dhe nr. 621 datë 21 qershor. Vetëm vendimi i 21 qeshorit u kundërshtua formalisht dhe u shfuqizua nga gjykata, duke qenë se ishte një akt normativ dhe nuk ishte miratuar me pesë vota siç parashikohej.

¹⁷ Për shembull, udhëzimi nr. 4 i datës 9 mars 2009 për organizimin dhe funksionimin e KQV-ve, i kushton vëmendje kontekstit të veçantë politik dhe kuadrin ligjor të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009.

¹⁸ Vendime të tjera të KQZ-së kërquan pesë vota përfshinë miratimin e fletëve të votimit dhe rendin e numërimit të fletëve të votimit në zonat ku u zhvilluan si zgjedhjet parlamentare, ashtu edhe ato të pjesshme të qeverisjes vendore.

¹⁹ Shih rubrikën për Median.

²⁰ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it konstatoi se të paktën 159 vendime të KQZ-së nuk ishin vënë në faqen e internetit.

KZAZ-të caktohen nga KQZ-ja për çdo zgjedhje. Ato përbëhen nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote.²¹ Megjithëse KZAZ-të përgjithësisht gëzuan besimin e palëve të interesuara dhe punuan në mënyrë kolegjinale, një numër KZAZ-sh u ndanë sipas linjave politike në vendimmarjen e tyre për çështje të debatueshme. Për më tepër, partitë politike zëvendësuan një numër të madh të anëtarëve të KZAZ-ve sipas dëshirës. Ata vazhduan me këtë praktikë gjër në ditën e zgjedhjeve dhe gjatë asaj dite, kur komisionet ishin trajnuar tashmë. Këto zëvendësime të vazhdueshme ngritën dyshime lidhur me paanshmërinë e KZAZ-ve dhe potencialisht reduktuan efektshmërinë e tyre.²²

Votimi u administrua nga KQV-të, të përbërë nga shtatë anëtarë, të caktuar nga KZAZ-të. Përbërja e tyre u bazua në emërimet politike dhe pasqyrore përbërjen e KZAZ-ve. Në gjysmën e KQV-ve, kryetarët u emëruan nga shumica parlamentare dhe në gjysmën tjetër nga opozita. Numërimi u zhvillua në VNV-të të administruara nga grupet e numërimit të përbërë nga katër anëtarë të emëruar nga KZAZ-të.²³

Partitë politike e përmbushën detyrimin e tyre për përfshirjen e të paktën 30% të përfaqësuesve nga secila gjini në anëtarësinë e përgjithshme të KZAZ-ve. Megjithatë, përfaqësimi i grave në KQV-të, siç u vu në dukje nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve, ishte në mënyrë të ndjeshme më i ulët, 14 përqind, dhe 16 përqind të KQV-ve, u kryesuan nga një femër.²⁴

Vëmendje mund t'i kushtohet vendosjes së kuotave gjinore për KQV-të dhe grupet e numërimit në administratën zgjedhore, që të jetë në përputhje me legjislacionin tjetër të vendit.

Përcaktimi i disa qendrave të votimit (QV-ve) dhe vendeve të numërimit (VNV-ve), sidomos në ndërtesa private, tejkaloan afatin për shkak të propozimeve të papërfunduara ose të dorëzuara me vonesë nga kryetarët e bashkive. Përveç kësaj, ka pasur kundërshtime lidhur me vendndodhjen e disa QV-ve.²⁵ Në kundërshtim me ligjin, KQZ-ja zhvendosi rreth 90 QV, për më tepër, pasi njoftimet për zgjedhësit ishin dërguar tashmë.²⁶

Të gjitha partitë politike me të drejtë të propozojnë kandidatura për KQV-të i dorëzuan emërimet shumë kohë pas skadimit të afateve ligjore, me sa duket me qëllim që të shmangnin dispozitën që ndalon zëvendësimin diskrecional të anëtarëve të KQV-ve, siç parashikohej për herë të parë në Kodin Zgjedhor të rishikuar në vitin 2012. Gjithashtu, grupet e numërimit u krijuan përgjithësisht pas afateve ligjore. Vonesa të tilla shkaktuan pasiguri dhe ndërprerje të përgatitjeve.

Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet për të ndaluar zëvendësimin diskrecional të anëtarëve të KZAZ-ve nga partitë politike. Duhet të respektohen me rigorozitet afatet ligjore për propozimin e anëtarëve

²¹ Formula e emërimit të anëtarëve të KZAZ-ve pasqyron atë të KQZ-së, më përjashtimin që në gjysmën e KZAZ-ve, kryetari emërohet nga partia më e madhe mazhoritare dhe në gjysmën tjetër, nga partia më e madhe e opozitës. Zëvendëskryetari dhe sekretari i përkasin partisë politike më të madhe që nuk drejton KZAZ-në përkatëse.

²² Zëvendësimi i 173 anëtarëve të KZAZ-ve përfaqëson rreth 24 përqind të numrit të tyre në total. OSBE/ODHIR-i më parë ka rekomanduar që të shfuqizohet mundësia e partive politike për të tërhequr anëtarët e KZAZ-ve. Megjithatë në vitin 2012, vetëm dispozita në lidhje me zëvendësimin e anëtarëve të KQV-ve u shfuqizua në Kodin Zgjedhor.

²³ Partitë që përbëjnë shumicën dhe opozitën parlamentare kanë secila dy anëtarë në grupet e numërimit.

²⁴ Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri parashikon një kuotë bazë prej 30% për përfaqësim gjinor në të gjitha nivelet e institucioneve të administratës zgjedhore; megjithatë Kodi Zgjedhor nuk përfshin kuotën gjinore për KQV-të dhe grupet e numërimit.

²⁵ Dy vendime të KQZ-së, një mbi vendosjen e tre QV-ve në një ndërtesë private dhe një tjetër mbi vendndodhjen e një VNV-je u shfuqizuan nga gjykata me arsyetimin se vendndodhjet nuk plotësonin kushtet ligjore.

²⁶ Shih nenin 62.4 të Kodit Zgjedhor. Dy ankesa që kundërshtonin ndryshimet e vonuara vendndodhjeve të QV-ve, u dorëzuan në gjykatë. Njëra u pranua dhe tjetra u rrëzua.

të KQV-ve dhe grupeve të numërimit. Gjithashtu, mund t'i kushtohet vëmendje parashikimit të mekanizmave për të emëruar anëtarët e mbetur të KQV-ve dhe grupeve të numërimit, të ngjashme me ato që zbatohen kur partitë politike nuk emërojnë kandidatët e tyre për KZAZ-të.

KQZ-ja zhvilloi trajnime për zyrtarët zgjedhorë, të cilat MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i vlerësoi në mënyrë pozitive, megjithëse efektiviteti i tyre shpesh ishte i kufizuar për shkak të emërimeve të vonuara dhe ndryshimeve në komisionet e niveleve më të ulët.

VII. TEKNOLOGJITË E REJA PËR ZGJEDHJET

Kodi Zgjedhor i caktoi detyrën KQZ-së që të testonte dy teknologji të reja zgjedhore për këto zgjedhje: sistemin elektronik të numërimit (SEN) në qarkun e Fierit dhe sistemin elektronik të verifikimit të zgjedhësve (SEV) në qarkun e Tiranës. KQZ-ja u urdhërua për të filluar përgatitjet për realizimin e dy projekteve brenda datës 23 gusht 2012 dhe të plotësonte të gjitha procedurat e prokurimit deri më 23 dhjetor 2012. Gjithashtu ishte e detyruar të hartonte dhe miratonte një plan veprimi për zbatimin e teknologjive të reja, të adoptonte rregulla plotësuese si dhe të nxjernte udhëzime për administratën zgjedhore.

Përgatitja për këto dy projekte pilote u zgjat përtej afateve ligjore dhe e bëri të pamundur zbatimin e suksesshëm të tyre.²⁷ Përveç kësaj, KQZ-ja nuk miratoi të gjitha aktet nënligjore e duhura, të nevojshme për testimin dhe zbatimin e sistemeve. Vendimi i KQZ-së që të ruante modelin e fletës së votimit, së bashku me numrin e madh të konkurrentëve në fletën e votimit, e bënë të pamundur implementimin e SEN-it me *hardware*-in (pajisjen kompjuterike) të zgjedhur. Vendimi i KQZ-së për të ndërprerë projektin pilot SEN u mor më 17 qershor. Gjithashtu, përgatitjet për SEV-in u dëmtuan nga mungesa e kritereve të qartë për suksesin e testit, siç u demonstrua në një test publik. Më 18 qershor KQZ-ja zyrtarisht anuloi gjithashtu edhe implementimin e sistemit SEV për shkak të numrit të problemeve të paparashikuara të cilat u identifikuan gjatë testimit në lidhje me sigurinë e sistemit dhe vonesat e mundshme gjatë votimit.²⁸ Gjatë gjithë këtij procesi mungoi planifikimi i detajuar dhe në kohë i projektit, bashkëpunimi i palëve të interesuara dhe edukimi i zgjedhësve, të nevojshme për të prokuruar, testuar, trajnuar dhe zbatuar këto sisteme komplekse.

Rekomandohet që çdo zbatim i projekteve pilote SEV dhe SEN të përcaktuara me ligj, të fillojë kohë më parë sesa zgjedhjet e ardhshme, duke përfshirë përgatitje të domosdoshme të tilla si miratimi i akteve nënligjore të detajuara dhe testimi i sistemeve.

VIII. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Shqipëria ka një sistem pasiv të regjistrimit të zgjedhësve. Listat e zgjedhësve (LZ-të) për zgjedhjet nxirren nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC-së), që mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në MB. Ndonëse zyrtarët e gjendjes civile të njësisive të qeverisjes vendore janë përgjegjëse për përmbajtjen e LZ-ve, kryetarët e njësisive certifikojnë saktësinë e tyre dhe informojnë KQZ-në për numrin e votuesve dhe vendndodhjet e QV-ve. KQZ-ja mbikëqyr procesin e përgjithshëm të hartimit të LZ-ve dhe mund të vendosë sanksione mbi drejtuesit

²⁷ Kontratat e prokurimit të SEN-it dhe SEV-it u nënshkruan përkatësisht më 16 dhe 25 mars. Testimi i SEN-it u zhvillua më 13 prill, 20 ditë pas afatit të përcaktuar.

²⁸ Më 20 qershor, PS-ja bëri një kallëzim tek prokuroria për të katër anëtarët të KQZ-së dhe nëpunësit përgjegjës të KQZ-së në bazë të nenit 248 të Kodit Penal, për shpërdorim të detyrës publike në lidhje me anulimin e projektit pilot SEV. Në korrik prokuroria nisi hetimin.

e institucioneve përkatëse. KQZ-ja gjobiti gjithsej 139 kryetarë të njërive të qeverisjes vendore për mosdorëzimin apo dorëzimin me vonesë të informacionit apo informacionit të paplotë mbi numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e QV-ve.

Sipas të dhënave të KQZ-së, 3,271,885 zgjedhës u përfshinë në LZ-të, bazuar në informacionin e kryetarëve të njërive vendore.²⁹ Zgjedhësit me banim jashtë shtetit gjendeshin në listën e zgjedhësve sipas adresës së fundit ku ishin regjistruar. Rreth 20 qendra votimi u ngritën në burgje dhe në qendrat e paraburgimit. Gjatë 40 ditëve përpara ditës së votimit zgjedhësit mund të futeshin në listat e zgjedhësve vetëm me vendim gjykatë; MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it konstatoi se kishte pak raste të tilla.

Në përgjithësi ekzistonte besim në lidhje me saktësinë dhe cilësinë e LZ-ve, por edhe disa shqetësime që u shprehën kryesisht nga partitë më të vogla politike. U ndërmorën masa të ndryshme për të përmirësuar saktësinë e regjistrimit kombëtar të zgjedhësve dhe LZ-ve. MB-ja informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it që numri i regjistrimeve të dyshuara si të dubluara ishte zvogëluar nga 7,674 në dhjetor 2012 në 1,139 në maj 2013. Në një përpjekje të përbashkët, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Urbanistikës reduktoi numrin e zgjedhësve pa kod adrese të plotë në periudhën shkurt-maj 2013 me rreth 35%, nga 542,808 në 348,346 persona, gjë e cila e përmirësoi më tej saktësinë dhe cilësinë e LZ-ve.³⁰

Duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet bashkëpunimi mes institucioneve qendrore dhe vendore në lidhje me masat për të zvogëluar numrin e regjistrimeve të dyshuara si të dubluara dhe numrin e zgjedhësve pa kod adrese të plotë, në mënyrë që të zgjidhen problemet e mbetura në lidhje me saktësinë e të dhënave për zgjedhësit.

LZ-të e përditësuara u publikuan çdo muaj duke filluar nga janari. Megjithëse LZ-të ishin afishuar për publikun, vëzhguesit ndërkombëtarë konstatuan si disa vonesa në afishimin e LZ-ve, ashtu edhe vendosjen e tyre në vende të vështira për t'u arrirë. Gjithashtu, zgjedhësit mund t'i kontrollonin detajet e tyre *online*. Megjithatë, efikasiteti i këtyre masave mund të ishte përmirësuar nëpërmjet informacionit më të zgjeruar për zgjedhësit. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re se zgjedhësit në më shumë se gjysmën e KZAZ-ve nuk ishin njoftuar as për vendndodhjen e QV-së së tyre dhe as për numrin e tyre në LZ-në, siç kërkohet me ligj.

Shtetasit që kanë mbushur 18 vjeç ose më shumë në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë vote, me përjashtim të atyre që janë shpallur të paaftë mendërisht me vendim gjykatë. Ligji detyroi MB-në të hiqte 1,130 shtetas të moshës 100 vjeç ose më shumë nga lista e zgjedhësve si masë për të trajtuar zgjedhësit që potencialisht nuk jetonin më dhe i detyroi ata të aplikonin për ripërfshirjen; rreth 380 njerëz e bënë këtë. Kjo praktikë përbën diskriminim në bazë të moshës, në kundërshtim me pikën 5.9 të angazhimeve të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Vëmendje mund t'i kushtohet ndërprerjes së praktikës së heqjes së zgjedhësve mbi moshën 100 vjeç nga listat e zgjedhësve dhe përfshirjes së masave jodiskriminuese për eliminimin e zgjedhësve që nuk jetojnë më.

Subjektet zgjedhore përdorën të drejtën e tyre për të marrë kopje të LZ-ve dhe disa ndihmuan zgjedhësit për të verifikuar të dhënat e tyre. Siç kërkohet me ligj, KQZ-ja caktoi dy auditorë, (të

²⁹ KQZ-ja raportoi 949 zgjedhës më shumë në krahasim me numrin e dhënë nga MB-ja.

³⁰ Zgjedhësit identifikohen nëpërmjet një numri 10-shifror (tre numrat e parë tregojnë bashkinë, katër të tjerët tregojnë qendrën e votimit dhe tre të fundit tregojnë kodin e adresës). Kur tre shifrat e fundit janë të panjohura, ato shënohen me 888, 999 ose 000.

propozuar nga PS dhe PD), për të verifikuar cilësinë e listës së zgjedhësve. Gjetjet dhe rekomandimet e tyre të veçanta u paraqitën në KQZ dhe u dërguan në MB. Megjithatë, kjo u bë shumë vonë, për të patur ndikim në saktësinë e LZ-ve.

IX. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Gjashtëdhjetë e gjashtë parti politike dhe dy kandidatë të pavarur u regjistruan si kandidatë në një proces gjerësisht gjithëpërfshirës që u ofroi zgjedhësve një zgjedhje të mirëfilltë. KQZ-ja fillimisht regjistroi 64 parti politike dhe 2 kandidatë të pavarur, ndërsa 6 parti si dhe 5 kandidatë të pavarur u refuzuan. Nga 6 partitë që e ankimuan vendimin e KQZ-së, 2 ankesa u pranuan dhe partitë u regjistruan nga gjykata.³¹ Asnjë nga kandidatët e pavarur nuk apeloj vendimin kundër regjistrimit.

Partitë politike të regjistruara sipas Ligjit për Partitë Politike, si dhe kandidatët e pavarur mund të regjistroheshin si subjekte zgjedhore.³² Listat e kandidatëve të partive politike jo-parlamentare që konkurruan në mënyrë individuale (jashtë koalicioneve), ose në koalicione që kanë më pak vende në parlamentin të cilit i mbaroi mandati, sesa numri i partive në koalicion, duhet të mbështeteshin nga firmat e përkatësisht 5,000 ose 7,000 zgjedhësve të regjistruar, të grumbulluara në mbarë vendin. Kandidatët e pavarur kishin nevojë për firmat e të paktën një përqind të zgjedhësve (por jo më shumë se 3,000 zgjedhës) të regjistruar në zonën përkatëse. Pasi u dha mundësinë partive për të bërë korrigjime, KQZ-ja miratoi të gjitha listat e kandidatëve, të cilat përfshinin një total prej 7,149 kandidatësh, duke përfshirë 2,753 gra. Jo të gjithë kandidatët që mbanin poste të nivelit të lartë dhanë dorëheqjen përpara regjistrimit siç e kërkonte ligji.³³

Çdo listë kandidatësh duhet sipas ligjit të përfshijë të paktën një mashkull dhe një femër në tre vendet e para dhe duhet të përbëhet të paktën nga 30% nga secila gjini. Për të përmbushur këtë kuotë, shumë parti vendosën gra në vendet e fundit të listës, në pozicione ku nuk mund të fitonin. Për më tepër, tre partitë më të mëdha parlamentare (PD; PS dhe LSI) nuk përmbushën kuotën gjinore përkatësisht në katër, gjashtë dhe katër zona. Megjithëse KQZ-ja u dha partive një mundësi të korrigjonin shkeljet në lidhje me kuotën gjinore, ato nuk e bënë këtë. Listat që nuk përputheshin me kërkesat u regjistruan dhe pastaj KQZ-ja vendosi gjoba për partitë.³⁴ Dispozita që detyronte KQZ-në të mohonte regjistrimin për listat që nuk përputheshin me kërkesat u shfuqizua në 2012. Për më tepër, midis palëve të interesuara, kishte interpretime të kundërta në lidhje me nenin 175.2 të Kodit Zgjedhor, që me sa duket e detyron KQZ-në të ndryshonte renditjen e listave të kandidatëve për të siguruar që të paktën një nga tre vendet e para të jetë përfaqësues nga secila gjini. Grupet e shoqërisë civile kritikuan faktin që KQZ-ja nuk e bëri këtë.

Vëmendje duhet t'i kushtohet promovimit të mëtejshëm të kandidateve gra. Dispozitat ligjore ekzistuese, të cilat lejojnë KQZ-në të ndryshonte rendin e listave të kandidatëve, mund të zbatohen

³¹ Në të dyja rastet e pranuar nga Kolegji Zgjedhor, KQZ-ja zbatoi kërkesa lidhur me dokumentacionin të cilat nuk përfshiheshin në kriteret ligjore për regjistrimin e partive. Në një rast tjetër, KQZ-ja refuzoi regjistrimin e një partie me arsyetimin se nuk përfshinte shkurtimin zyrtar, i cili nuk kërkohet me ligj. Rastet e tjera të refuzimit të regjistrimit duket se kishin bazë të shëndoshë ligjore.

³² Subjektet zgjedhore përkufizohen në Kodin Zgjedhor si partitë politike të regjistruara, koalicionet, kandidatët e propozuar nga një grup zgjedhësish dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore.

³³ Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, zyrtar i lartë i administratës publike, ishte kandidat në listën e PD-së për Tiranën dhe dha dorëheqjen vetëm më 19 qershor.

³⁴ Në vitin 2012, gjoba për paputhshmëritë në lista, u rrit nga 30 000 lekë (215 Euro) në 1 milion lekë (7 120 Euro) (afërsisht 1 Euro = 140 lekë). Partia Popullore Kristian Demokrate u gjobit për përfshirjen e më shumë grave në tetë nga listat e kandidatëve të saj; gjoba u shfuqizua nga gjykata bazuar me arsyetimin se KQZ nuk i kishte dhënë mundësinë partisë të korrigjonte listat e saj.

si dhe mund të vendosen gjithashtu edhe sanksione të tjera të mundshme në rast moszbatimi. Gjithashtu, Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet për të parashikuar pozicionimin më të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të kandidatëve gra në listat e partive politike.

X. FUSHATA ZGJEDHORE

Kandidatët u angazhuan aktivisht në një fushatë të ethshme. Liritë themelore u respektuan dhe të gjithë kandidatët patën mundësinë të bëjnë fushatë lirisht. Klima e fushatës ishte përgjithësisht paqësore, me vetëm pak incidente të dhunshme të izoluar.³⁵ Dy zyra të fushatës u dhunuan.³⁶

Partitë politike filluan të bënin fushatë aktive përpara fillimit të fushatës zyrtare në 24 maj, dhe figurat kryesore politike dhe zyrtarët e lartë të qeverisë udhëtuan në të gjithë vendin për të prezantuar kandidatët në tubime të shkallës së gjerë. Partitë e përfaqësuara në parlamentin aktual organizuan tubime të gjera dhe koncerte dhe përdorën gjerësisht postera dhe banera. Partitë e tjera zhvilluan takime të shkallës më të vogël dhe shpërndanë fletëpalosje vetëm në zonat ku prisnin mbështetje. Shumica e partive përdorën median sociale gjerësisht gjatë gjithë fushatës. Numri i debateve të drejtpërdrejta midis kandidatëve apo drejtuesve të partive politike ishte i kufizuar dhe mungonin figurat kryesore.

Shumica e partive promovuan platforma me objektiva të ngjashme: zhvillimi ekonomik, mundësi punësimi, lufta kundër korrupsionit, dhe integrimi Evropian. Tiparet më evidente të debatit publik kishin të bënin me sigurimet shoqërore dhe me çështjen e tatimeve dhe taksave. Ndërsa PD-ja theksonte arritjet e qeverisë, dhe PS-ja premtonte një fillim të ri. LSI-ja kritikoi qeverinë dhe u fokusua mbi krijimin e vendeve të punës dhe bashkimin me strukturat evropiane. Akuzat e ndërsjella midis dy partive më të mëdha dhe drejtuesve të tyre herë pas here e largonin vëmendjen nga thelbi i fushatës.

Ndërsa disa kryetarë të njësive vendore i përmbushën detyrimet e tyre ligjore për të ofruar hapësirë për reklamë partive politike me anë të një vendimi zyrtar, të tjerë nuk e bënë këtë, ose miratuan ndarjen e hapësirës vetëm ndërmjet partive më të mëdha.³⁷ MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it konstatoi përdorimin e automjeteve publike dhe të ndërtesave zyrtare për qëllime fushate nga dy partitë më të mëdha, gjë e cila ndalohej me ligj. Në Tiranë disa automjete të sektorit publik përdorëshin herë pas here për të ekspozuar flamujt e PD-së, dhe flamujt e partive ishin parë gjithashtu në autobusët publikë në Kamzë (PD), Gjirokastrë (PS) dhe Delvinë (Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)). Ndërtesat e bashkive u përdorën gjatë tubimeve nga PD-ja dhe PDIU-ja në Krujë dhe Durrës, dhe nga PS-ja në Gramsh dhe Librazhd. Në 13 maj Kryeministri nxori një urdhër që i detyronte zyrtarët e lartë publikë të ndalonin përdorimin e fondeve dhe mjeteve publike për qëllime fushate, gjë që përforcoi dispozitat ligjore ekzistuese.

Një sërë ngjarjesh të axhendës qeveritare, si hapja e rrugëve dhe uzinave, si dhe shkollat dhe spitalet e

³⁵ Incidentet përfshinë disa të shtëna në tentativa me armë ndaj kryetarit të komisionit vendor (të PD-se) në Komunën Shtiqen (Kukës); shpërthimi i një pajisjeje eksplozive jashtë banesës së një kandidati të PD-së në Vlorë; rrahja e një kandidati të FRD-së në Fier dhe rrahja e një anëtarit të emëruar nga PS-ja në një KQV në qarkun e Beratit.

³⁶ Zyra e PD-së në Vlorë u sulmua në 27 maj, dhe zyra e PS-së në Tiranë u plaçkit më 1 qershor.

³⁷ Shih nenin 79 të Kodit Zgjedhor. Kryetari i Bashkisë Tiranë informoi MVZ-në e OSBE/ODHIR-it që ata nuk kishin marrë asnjë vendim formal në lidhje me vendet dhe hapësirat e përcaktuara për fushatë, por besuan në vetë-rregullim nga partitë politike; Bashkia do të ndërhynte vetëm në rast problemesh ose prishjeje të rendit publik. Në Vlorë, Kryetari i Bashkisë nuk pranoi t'u japë kandidatit të pavarur si edhe Aleancës Kuq e Zi informacionin në lidhje me vendet dhe hapësirat e përcaktuara për fushatë. FRD-ja ngrii pretendime të ngjashme në Shkodër.

rinovuara u shoqëruan me fjalime dhe reklamimin e fushatës së partisë në pushtet. Gjithashtu, pati mbulim të fushatës në faqen zyrtare të internetit të Kryeministrit. Këto raste të zbehjes së vazhdueshme të kufijve midis institucioneve shtetërore dhe interesave partiake duket se bien në kundërshtim me pikën 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990.

Abuzimi me burimet shtetërore, përfshirë burimet njerëzore, për qëllime të fushatës zgjedhore mund të ndalohet në mënyrë më të efektshme nëpërmjet zbatimit më të mirë të ligjit dhe vënies përpara përgjegjësisë të personave që e shkelin atë.

Pretendime të përhapura gjerësisht se punonjësve të sektorit publik u kërkohet nga shefat e tyre të merrnin pjesë në tubime zgjedhore apo të siguronin mbështetje për partinë në fuqi ndikuan negativisht në klimën para-zgjedhore.³⁸ PS-ja i kërkoi Prokurorit të Përgjithshëm që të krijonte një *task forcë* kombëtare për të hetuar këto vepra penale dhe akte të tjera që lidheshin me fushatën. Kërkesa u refuzua zyrtarisht.

MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it konstatoi raste specifike të shkollave që ishin të mbyllura gjatë tubimeve të zhvilluara gjatë orarit të mësimin, sepse mësuesit dhe nxënësit ishin të detyruar të merrnin pjesë.³⁹ Në këto dhe të tjera ngjarje të ngjashme, MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it konstatoi se rreth 30 përqind e pjesëmarrësve ishin nxënës shkolle.

PS-ja pretendoi se aktivistët dhe mbështetësit e saj, duke përfshirë edhe anëtarët e KQV-ve të zgjedhjeve të mëparshme si dhe familjarët e tyre, janë pushuar nga puna në sektorin publik për arsye politike. Në disa raste, vëzhguesit e MVZ-së së OSBE/ODHIR-it takuan me persona të pushuar nga puna dhe i vlerësuan këto pretendime si të besueshme.⁴⁰ Këto veprime bien në kundërshtim me paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990.⁴¹

Autoritetet dhe partitë politike mund të konsiderojnë marrjen e hapave më të vendosura për të siguruar që nuk ushtrohet presion mbi punonjësit e sektorit publik, aktivistët politikë si dhe persona të tjerë për të marrë pjesë në veprimtarinë e fushatës ose për të votuar në një mënyrë të caktuar. Çdo presion i tillë duhet të hetohet dhe autorët të vihen përpara drejtësisë sipas ligjit.

Pretendimet për blerjen e votës, të bëra dhe nga dy partitë politike më të mëdha kundër njëra-tjetrës dhe kundër LSI-së, u intensifikuan në ditët para ditës së zgjedhjeve dhe cenuan klimën zgjedhore.⁴² Shumë prej pretendimeve për blerjen e votës fokusoheshin mbi grupet vulnerabël, veçanërisht në komunitetin rom dhe egjiptian, sidomos në zonat rurale.

³⁸ Në Laç u raportua se një drejtor shkolle u pushua nga puna sepse u raportua se nuk zbatoi urdhrin e shefit të tij për të dërguar mësuesit në tubimin e PD-së. PS-ja bëri një kallëzim penal duke pretenduar që një drejtor në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë urdhëroi zyrtarisht me shkrim punonjësit e saj që të mblidhnin informacione rreth votues të vendosur për PD-në.

³⁹ Kjo u vu re gjatë një tubimi të PD-së në Kukës më 23 maj dhe një tubimi të PS-së në Divjakë më 8 qershor.

⁴⁰ Shih gjithashtu rubrikën mbi Ankimin në Rrugë Administrative dhe Gjyqësore.

⁴¹ Paragrafi 7.7 parashikon zhvillimin e fushatës në një atmosferë ku zgjedhësit të mund të votojnë pa patur frikë nga ndëshkimi.

⁴² MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it ka marrë raporte të shumta mbi blerjen e votës nga të paktën shtatë qarqe dhe u njoftua për të paktën dy arrestime. Një kandidat i PD-së u filmua më një kamera të fshtë duke blerë vota në Tiranë dhe u transmetua nga një emision televiziv më 11 qershor, në bazë të të cilit PS-ja depozitoi një kallëzim penal në Prokurorinë e Tiranës. Në 21 qershor, policia në Tropojë arrestoi një person në Lekbibaj nën akuzën e blerjes së votës dhe bëri një deklaratë për shtyp ku u kërkonte banorëve të zonës të kallëzonin përpjekjet për blerjen e votave të tyre. Vëzhguesi afatgjatë i OSBE/ODHIR-it në Kukës konfirmoi një përpjekje për blerjen e votave të studentëve të universitetit.

Institucionet e zbatimit të ligjit mund të rrisin përpjekjet për identifikimin, hetimin dhe ngritjen e akuzave për rastet e blerjes së votave.

XI. FINANCIMI I FUSHATËS

Partitë politike mund të financojnë fushatën e tyre zgjedhore me fondet publike dhe donacionet private, si dhe me kredi. Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të marrin financim publik. Partitë politike marrin pjesën e tyre të fondit publik në bazë të numrit të votave të vlefshme që kanë marrë në zgjedhjet e mëparshme; 95 përqind e fondit shpërndahet midis partive që morën më shumë se 0.5 përqind të votave të vlefshme, ndërsa 5 përqind që mbetet u shpërndahet partive që morën më pak se 0.5 përqind e votave dhe partive që nuk morën pjesë në zgjedhjet e fundit; 53 parti ishin në këtë kategori. Vendimi për të shpërndarë paraprakisht fonde për fushatë u mor 11 ditë pas fillimit të fushatës zyrtare për shkak të vendimit të vonuar të parlamentit.⁴³

Donacionet private për fushatën lejohen me një kufi prej 1 milionë lekë për çdo donacion individual dhe me një kufi të përgjithshëm shpenzimesh jo më shumë se dhjetë herë nga shuma më e madhe e dhënë nga buxheti i shtetit për një subjekt të zgjedhur. Subjektet ishin të detyruar të mbanin një regjistër të donatorëve privatë dhe të donacioneve, por të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës duhet t'u raportoheshin vetëm auditëve të caktuar nga KQZ-ja pas shpalljes së rezultateve përfundimtare. KQZ-ja është gjithashtu përgjegjëse për marrjen dhe publikimin e raporteve vjetore mbi financimet e zakonshme të partive politike jashtë periudhës zgjedhore.⁴⁴ Kuadri ligjor nuk garanton transparencë të mjaftueshme në lidhje me raportimin mbi financimin e fushatës, sepse nuk ka asnjë detyrim për deklarimin e tyre përpara ditës së zgjedhjeve. Pas zgjedhjeve KQZ-së i kërkohet të publikojë vetëm raportet e auditimit si dhe informacion mbi donatorët që kontribuan me më shumë se 100,000 lekë.

Për të rritur transparencën e financimit të fushatës, rekomandohet të detyrohen pjesëmarrësit në zgjedhje t'i raportojnë rregullisht KQZ-së të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për qëllime fushate dhe t'i kërkohet KQZ-së që të publikojë raporte paraprake të financimit të fushatës përpara ditës së zgjedhjeve.

XII. MEDIA

A. MJEDISI I MEDIAS

Një gamë e gjerë mediash operojnë në Shqipëri. Sipas Autoritetit të Mediave Audiovizuale (AMA), ka tre kanale televizive kombëtare (kanali publik *TVSh*, *TV Klan* dhe *Top Channel*), 71 kanale televizive lokale, 83 kanale televizive kablore dhe 59 stacione radio.⁴⁵ Ka shumë media të shkruara, megjithëse qarkullimi dhe ndikimi i tyre është i kufizuar. Interneti ofron një sferë të hapur për diskursin publik.⁴⁶ Televizioni zotëron pjesën më të madhe të tregut të reklamave dhe konsiderohet si burimi parësor i informacionit për shkak të mbulimit të gjerë gjeografik të tij.

⁴³ Parlamenti shpërndau 65 milionë lekë për financimin publik të fushatës zgjedhore.

⁴⁴ Më 27 qershor, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) i Këshillit të Evropës nxori një raport i cili trajtonte problemin e financimit të partive politike, dhe vlerësoi përgjithësisht me terma pozitivë masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare për rritjen e transparencës në këtë fushë.

⁴⁵ AMA është emërtimi i ri i Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit, i cili shërben si institucioni rregullator kombëtar dhe autoriteti liçensues.

⁴⁶ Sipas Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në fillim të vitit 2012, kishte rreth 175,000 familje me abonim të internetit me bandë të gjerë.

B. KUADRI LIGJOR

Kushtetuta parashikon lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias pa censurë. Media audiovizive rregullohet kryesisht me ligj.⁴⁷ AMA është përgjegjëse për zbatimin e ligjit, dhënien e licensave, monitorimin e medias dhe rialokimin e frekuencave pas kalimit në transmetime dixhitale. Bordet drejtuese të AMA-s dhe të transmetuesit publik *RTSh* kanë respektivisht, shtatë dhe njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët zgjidhen nga parlamenti. Bashkëbiseduesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë shprehur shqetësim që mekanizmat e emërimit të tyre mund të kërcënojnë pavarësinë e dy autoriteteve nga shumica parlamentare.⁴⁸

Kodi Zgjedhor krijon një bazë të gjerë ligjore për pasqyrimin e zgjedhjeve në media; ai parashikon rregulla për minutazhin e transmetimit falas, pasqyrim në edicionet informative dhe reklamën me pagesë. Dispozitat e tij zbatohen për të gjitha mediat audiovizive gjatë fushatës. Media publike dhe private janë të detyruara t'u ofrojnë një pasqyrim të barabartë në lajme partive të mëdha politike, dyfishin e kohës së transmetimit krahasuar me parti të tjera parlamentare. Pasqyrimi në lajme për partitë jo-parlamentare vendoset nga kryeredaktorët. Ndalohet propaganda nga gazetarët gjatë edicioneve informative. Lajmet në lidhje me institucionet publike të cilat promovojnë arritjet e tyre konsiderohen se janë për qëllime zgjedhore, kështu që llogariten në kohën e transmetimit të partisë së cilës i përket titullari i institucionit.

Kodi Zgjedhor detyron *TVSh-në* t'u ofrojë minutazh falas të gjitha partive politike sipas përfaqësimit të tyre në parlament. KQZ-ja e udhëzoi atë t'u ofrojë 60 minuta partive të cilat kanë më shumë se 20 përqind të vendeve në parlament, 30 minuta partive të tjera parlamentare, 10 minuta partive jo-parlamentare dhe 5 minuta kandidatëve të pavarur.⁴⁹

Transmetimi i reklamave politike me pagesë lejohet në median private gjatë fushatës zgjedhore zyrtare, por jo më shumë se 90 minuta në çdo media audiovizive. Sipas ligjit, mediat janë të detyruar që të paraqesin tarifën e transmetimit përpara fillimit të fushatës zyrtare. Megjithatë, KQZ-ja zgjati afatin ligjor me tri ditë dhe lista e tarifave e publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së nuk ishte e plotë.⁵⁰

Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), i cili ka detyrë të monitorojë respektimin e Kodit Zgjedhor nga mediat, u krijua nga KQZ-ja më 21 maj, 37 ditë pas afatit ligjor. Çdo anëtar i KQZ-së emëron një anëtar të BMM-së bazuar në propozimet e organizatave jofitimprurëse të medias. Megjithatë, vonesat në proces dhe pasaktësitë në listën e organizatave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë penguan mekanizmin e emërimit.⁵¹ Anëtarët e BMM-së shpesh u ndanë sipas linjave politike, duke mos vepruar në mënyrë të pavarur dhe objektive. Krijimi i vonë i BMM-së dhe mungesa e kolegjalitetit reduktuan efektshmërinë e tij.

⁴⁷ Ligji për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat i vitit 1998 u ndryshua së fundmi më 4 mars 2013

⁴⁸ Në Raportin Periodik për Këshillin e Përhershëm të 13 qershorit 2013, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias tregoi se ligji nuk arrin të kërkojë organe që janë politikisht përfshirëse për rregullatorin kombëtar të transmetimit dhe transmetuesin publik, duke rrezikuar kështu që të dyja institucionet të mbesin instrumentë politikë të shumicës parlamentare. Shih: <http://www.osce.org/fom/102651>.

⁴⁹ Radha e transmetimeve u vendos me short më 21 maj. Një boshllëk ligjor në Kodin Zgjedhor për garantimin e minutazhit falas për kandidatët e pavarur bëri që KQZ-ja të miratonte një vendim që i kërkon transmetuesit publik për të siguruar minutazh për kandidatët e pavarur.

⁵⁰ Për shembull, dy kanalet televizive private me licensë kombëtare, *Top Channel* dhe *TV Klan*, nuk përfshihen në listën e tarifave megjithëse ato tranmestuan reklama politike të shumta me pagesë gjatë fushatës.

⁵¹ Vetëm 14 nga 54 organizata jofitimprurëse u njoftuan nga KQZ-ja dhe vetëm tetë prej organizatave propozuan kandidatë.

Vëmendje mund t'i kushtohet emërimit në kohë të anëtarëve të BMM-së dhe sigurimit të një procesi gjithëpërfshirës për të gjitha organizatat jofitimprurëse mediatike, në mënyrë që të identifikohen profesionistë të përshtatshëm të fushës së medias.

BMM-ja nuk i dha KQZ-së raporte ditore siç kërkohet me ligj dhe paraqiti vetëm tre raporte javore të cilat përmbanin një numër pasaktësish.⁵² Për më tepër, edhe pse kërkohet ligjërisht që të shqyrtoheshin raportet e BMM-së të paktën një herë në javë dhe që të vendosej në lidhje me propozimet e BMM-së ose të anëtarëve të tij individualë, KQZ-ja shqyrtoi vetëm dy raporte javore dhe nuk u kushtoi vëmendje kërkesave të paraqitura nga anëtarët e BMM-së të emëruar nga opozita. Vendimet e KQZ-së për kompensim të kohës së transmetimit nuk u zbatuan efektisht; kështu rastet e anësisë nuk u korrigjuan nga të gjithë transmetuesit. Megjithatë, nuk u depozitua asnjë ankesë formale në lidhje me çështjet mbi median.

Vëmendje mund t'i kushtohet përcaktimit të mëtejshëm të detyrave dhe përgjegjësiive të BMM-së, duke përfshirë procedura për shqyrtimin e ankesave dhe pasjen e më shumë trajnimeve për stafin monitorues të medias.

Materialet mbi fushatën të regjistruara më parë të përgatitura nga partitë politike mund të transmetohen në lajme, por ligji kërkon që materialet të jenë qartësisht të identifikueshme si propagandë në përputhje me udhëzimet e KQZ-së.⁵³

Më 3 qershor, KQZ-ja miratoi një vendim të diskutueshëm i cili nënkuptonte kërkesën për mediat audiovizive të transmetonin në lajme kaseta të përgatitura nga subjektet zgjedhore, duke shpërfillur vendimin gjyqësor e vitit 2011, i cili shfuqizoi një vendim të mëparshëm të KQZ-së mbi të njëjtën çështje. Vendimi i 3 qershorit pengoi lirinë editoriale të medias, tejkaloi pushtetin rregullues të KQZ-së, dhe nuk është në përputhje me angazhimet e OSBE-së as standardet e Këshillit të Evropës.⁵⁴ Ky vendim u dha partive politike një ndikim të padrejtë në lidhje me lirinë editoriale të transmetuesve, duke kufizuar aksesin e shikuesve për informimin e pavarur. Avokati i Popullit i rekomandoi KQZ-së që të shfuqizonte vendimin e saj; megjithatë KQZ-ja nuk reagoi përpara mbarimit të fushatës.⁵⁵

Vëmendje mund t'i kushtohet ndryshimit të nenit 84.1 të Kodit Zgjedhor, duke sqaruar më tej se çdo material të lidhur me fushatën i përgatitur nga subjektet zgjedhore duhet të identifikohet si material propagandistik dhe të mos detyrohen transmetuesit të transmetojnë në edicionet informative materiale të tilla të regjistruara më parë.

⁵² Raporti i parë javor i BMM-së përmbante statistika sipas koalicioneve në vend që të ishin për parti politike dhe nuk përfshinte kohën e transmetimit që u kushtohet aktiviteteve të organeve të qeverisjes vendore. Gjithashtu, llogaritjet nga BMM-ja për kompesim të kohës televizive për të korrigjuar mbulimin mediatik të pabalancuar të partive të vogla parlamentare ishin të pasakta meqenëse ato kanë të drejtë të marrin gjysmën e masës së mbulimit informative që i kushtohet partive të mëdha.

⁵³ Udhëzimet e KQZ-së kërkuar vetëm se materiali të identifikohet në përkatësinë e partisë politike përkatëse.

⁵⁴ Shih paragrafin 9.1 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990, paragrafin 26 të Dokumentit të Takimit të Moskës të vitit 1991 dhe paragrafin I.3 të Rekomandimeve të KE-së si dhe paragrafin 1.3 të Rekomandimit të KM-së CM/Rec (2007) në të cilin thuhet se “Kornizat rregullatore për mbulimin e zgjedhjeve nga ana e medias duhet të respektojnë pavarësinë editoriale të medias”.

⁵⁵ Rekomandimi iu dërgua KQZ-së më 11 qershor. Sipas ligjit, KQZ-ja kishte 30 ditë për t'iu përgjigjur, Më 6 gusht, KQZ-ja e refuzoi kërkesën e Avokatit të Popullit për pavlefshmërinë e vendimit të saj. Përgjigja e vonuar pas zgjedhjeve thekson mungesën e një zgjidhjeje në kohë dhe efikase.

C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAS

Gjetjet e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it treguan që media u ofroi një pasqyrim të gjerë zgjedhjeve.⁵⁶ Gjashtë kanalet televizive të monitoruara, ofruan mbi 387 orë transmetimi mbi çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, brenda programeve të llojeve të ndryshme duke përfshirë lajmet, minutazh falas dhe të paguar, programe informimi dhe debate. Mediat audiovizive, përgjithësisht u ofruan mbulim të mjaftueshëm partive kryesore politike, duke informuar zgjedhësit për qëndrimet e ndryshme politike.

Televizioni publik *TVSH* u ofroi minutazh falas të gjithë konkurruesve dhe pasqyrim të njëjtë në lajme partive politike kryesore (40 përqind PD-së, 6 përqind qeverisë, 41 përqind PS-së). Megjithatë nuk e përmbushi detyrimin e tij ligjor të paanshmërisë në mbulimin e lajmeve, duke u përdorur një ton më pozitive ndaj PD-së dhe qeverisë (45 përqind për PD-në krahasuar me më pak se 1 përqind për PS-në). Të gjitha partitë e tjera politike patën një pasqyrim në lajme vetëm, në total, 13 përqind.

Gjithashtu, mediat e monitoruara nuk përmbushën detyrimet që t'iu ofronin partive parlamentare të cilat kanë marrë më pak se 20 përqind të vendeve në parlament gjysmën e kohës së vënë në dispozicion për partitë më të mëdha. Edhe pse vendimi ishte në diskrecion të kryeredaktorëve, media u ofroi konkurruesve të rinj, mbulim shumë të kufizuar në lajme. Dy partitë politike më të mëdha, tejkalojnë në masë të konsiderueshme kufirin prej 90 minutash të reklamave të paguara, por autoritetet kompetente nuk e vunë re ose nuk reagojnë ndaj shkeljes.⁵⁷

Televizionet private ndryshonin në mbulimin e tyre. *TV Klan* favorizoi PD-në me 53 përqind të mbulimit të lajmeve, në të shumtën e rasteve me një qasje pozitive, krahasuar me 28 përqind për PS-në, shpesh me qasje negative. *Top Channel* dhe *Vizion Plus* ishin më të balancuar në mbulim, megjithëse u vu re një ton më negativ ndaj qeverisë. Kanalet televizive *News 24* dhe *Ora News* ofruan mbulim më të gjerë për partitë kryesore i cili në përgjithësi ishte i paanshëm. Mediat e shkruara treguan njëfarë polarizimi, ku gazetat Shqip dhe Shqiptarja.com kryesisht favorizonin opozitën ndërsa gazetat *Mapo* dhe *Panorama* partinë qeverisëse në pushtet.

Kandidatet gra gjetën mbulim shumë të pakët në lajme duke nxjerrë në pah problemet e vazhdueshme në lidhje me pjesëmarrjen e grave në jetën politike. *TVSh* u ofroi kandidateve gra vetëm katër përqind në mbulimin e lajmeve. Mediat private u sollën njësoj.⁵⁸

Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe dukshmërisë së grave në fushatën zgjedhore, transmetuesi publik mund të ketë në vëmendje nxitjen aktive të pjesëmarrjes së grave duke dhënë mbulim më të gjerë për kandidatet gra në edicionet informative, ndërsa BMM-ja mund të përfshijë një komponent gjinor në metodologjinë e tij për monitorimin e medias.

⁵⁶ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi mbulimin politik në orarin e shikueshmërisë më të lartë (18:00-24:00) në gjashtë kanale televizive (*TVSh*, *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus*, *News24* dhe *Ora News*), si dhe në katër gazeta të përditshme (*Panorama*, *Shqip*, *Mapo* dhe *Shqiptarja.com*) përgjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore (24 maj – 23 qershor).

⁵⁷ Monitorimi mediatik i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it nxori në pah se PD-ja e kaloi kufirin ligjor prej 90 minutash në *TV Klan* (187 minuta), *Vizion Plus* (235 minuta), *News 24* (204 minuta), *Ora News* (226 minuta). PS-ja e kaloi kufirin ligjor për minutazhin në *TV Klan* (148 minuta), *Top Channel* (148 minuta), *Vizion Plus* (161 minuta), *News 24* (125 minuta), *Ora News* (111 minuta).

⁵⁸ Neni 4.1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) vëren që mund të përdoren “masat e veçanta të përkohëshme me qëllim përsheptimin *de facto* të barazisë ndërmjet burrave dhe grave.”

XIII. ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Aktorëve të zgjedhjeve nuk iu siguruan në mënyrë të mjaftueshme mjetet korrigjuese efikase ligjore dhe proces i rregullt ligjor për zgjidhjen e ankesave, në kundërshtim me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 dhe paragrafit II.3.3 të Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore, të Komisionit të Venecias. Kuadrit ligjor i mungon qartësia në lidhje me një proces efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Në çështje të rëndësishme, KQZ-ja, Kolegji Zgjedhor dhe Gjykata Kushtetuese refuzuan të shqyrtonin ankime ose tejkaloan kompetencat e tyre. Subjektet zgjedhore rrallëherë përdorën mekanizmat e disponueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore të lindura, për shkaqet që përfshijnë mungesën e besimit të raportuar në administratën zgjedhore, gjykatat dhe institucionet e zbatimit të ligjit si dhe për arsye të praktikës ekzistuese për arritjen e marrëveshjeve politike.

Ankesat kundër vendimeve të KZAZ-ve mund të paraqiten në KQZ, megjithëse asnjë nuk u depozitua në periudhën parazgjedhore. Vendimet e KQZ-së mund të kundërshtohen në Kolegjin Zgjedhor.⁵⁹ Kolegji Zgjedhor gjykoj 15 ankesa në periudhën parazgjedhore: tetë kishin të bënin me regjistrimin e partive politike, gjashtë me administratën zgjedhore, dhe një me kundërshtimin e gjobës për mosrespektimin e kuotës gjinore. Kolegji Zgjedhor ka një afat prej 10 ditësh për gjykimin e çështjeve, i cili është një afat shumë i gjatë dhe jo i përshtatshëm në një periudhë parazgjedhore.⁶⁰ Sipas disa partive politike, ky afat i zgjatur ishte arsyeja që ato nuk bënë ankesa, në përpjekje për të mos e ngadalësuar procesin zgjedhor. Sipas nenit 158.5 të Kodit Zgjedhor, vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë përfundimtare. Kjo nuk është në përputhje me nenin 43 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e ankimit të një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë.

Vëmendje mund t'i kushtohet shkurtimit të afatit për gjykimin e çështjeve parazgjedhore nga Kolegji Zgjedhor në tre deri në pesë ditë (dhe jo më vonë se dita e zgjedhjeve), mundësimin të së drejtës për ankim gjyqësor, si dhe publikimit të të gjitha vendimeve të Kolegjit Zgjedhor.

Për më tepër, Gjykata Kushtetuese ngarkohet sipas nenit 131.f të Kushtetutës të vendosë përfundimisht në lidhje me ankimet e individëve për shkeljen e drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Megjithatë, Gjykata refuzoi juridiksionin për të rishikuar vendime të Kolegjit Zgjedhor në lidhje me respektimin e këtij parimi.⁶¹ Për më tepër, nuk ka afate për gjykimin e çështjeve në lidhje me procesin e rregullt ligjor, edhe ato që lidhen me procesin zgjedhor.

PS-ja bëri kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke kundërshtuar si anti-kushtetues vendimin e parlamentit në lidhje me shpërndarjen e mandateve sipas zonave zgjedhore. PS-ja argumentoi se parlamenti nuk kishte kompetencën ligjore që të merrte këtë vendim pa propozim të KQZ-së dhe se mospërdorimi nga ana e tij të statistikave aktuale në lidhje me shpërndarjen e popullsisë ka shkelur barazinë e votës. Gjykata refuzoi juridiksionin në lidhje me këtë çështje pa një bazë të shëndoshë ligjore, duke vendosur se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike.⁶² Duke qenë se vendimet e

⁵⁹ Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Gjykata e Apelit përpara çdo zgjedhje kombëtare. E drejta e partive politike që secila të kundërshtonte një gjyqtar pas zgjedhjes së tyre u shfuqizua në 2012, duket rritur pavarësinë e institucionit. Juridiksioni i tij është i kufizuar vetëm me gjykimin e ankesave kundër KQZ-së.

⁶⁰ Shiko paragrafin II.3.3.g të Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias në të cilin thuhet që "afatet kohore për paraqitjen e ankesave dhe marrjen e vendimeve për to duhet të jenë të shkurtër (tre deri në pesë ditë për çdo rast në shkallën e parë).

⁶¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 53, datë 7 maj 2013, i cili ka të bëjë me zgjedhjet vendore të vitit 2011, është i detyrueshëm.

⁶² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 35 datë 7 mars 2013.

parlamentit nuk rishikohen nga Kolegji Zgjedhor ose ndonjë gjykatë tjetër përveç Gjykatës Kushtetuese, kërkuesit ju mohua e drejta për një mjet korrigjimi ligjor.

Gjykata Kushtetuese duhet të mos refuzojë në mënyrë të papërshtatshme juridiksonin për rishikimin e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor dhe të vendimeve të parlamentit për shkeljen e garancive kushtetuese të procesit të rregullt ligjor; ligji duhet të parashikojë afate të përshpejtuara për paraqitjen dhe gjykimin e kërkesave që kanë lidhje me zgjedhjet në Gjykatën Kushtetuese.

Sipas Kodit Zgjedhor, vetëm konkurruesit në zgjedhje kanë të drejtë të bëjnë ankesa kundër institucioneve të administratës zgjedhore. Zgjedhësit dhe grupet e shoqërisë civile nuk mund të kundërshtojnë vendime administrative ose veprime të tjera që prekin të drejtat publike zgjedhore të tyre ose të drejtat e tyre për votim, përveç disa përjashtimeve të vogla.⁶³ Edhe zbatimi nga KQZ-ja i dispozitave rreth kuotave gjinore dhe aktet nënligjore rreth transmetuesve mediatik nuk mund të kundërshtohen. Për më tepër, publiku nuk mund të ankohet administrativisht në lidhje me veprime të parregullta gjatë fushatës. Këto kufizime nuk marrin parasysh interesin publik në procesin zgjedhor.

Kodi Zgjedhor duhet të garantojë të drejtat e të gjitha palëve të interesuara për të paraqitur ankesa administrative kundër vendimeve dhe veprimeve të komisioneve zgjedhore, veprimeve të parregullta gjatë fushatës, parregullsive në ditën e zgjedhjeve si dhe rezultateve.

Mosmarrja e një vendimi nga KQZ-ja në lidhje me numrin e ZAZ-ve u kundërshtua në Kolegjin Zgjedhor. Në vendimin e tij, Kolegji Zgjedhor përcaktoi numrin e ZAZ-ve, në kundërshtim me ligjin, i cili i kërkon Kolegjit Zgjedhor të urdhërojë KQZ-në të marrë vendimin.⁶⁴ Për më tepër, në dy çështje në lidhje me vendndodhjen e paligjshme të QV-ve dhe KQV-ve, vendosur nga KQZ-ja, Kolegji Zgjedhor zgjodhi vendndodhje të reja në vend që të dërgonte çështjen përsëri në KQZ-në për marrjen e vendimit të ri. Në këto raste Kolegji Zgjedhor mori përsipër përgjegjësitë administrative dhe pushtetin diskrecional të KQZ-së.⁶⁵

Kolegji Zgjedhor duhet të veprojë brenda kompetencave të tij dhe duhet ta detyrojë KQZ-në të miratojë vendimet e kërkuara. Çdo vendim i KQZ-së, i cili përmban elementë diskrecional, duhet t'i kthehet KQZ-së dhe ajo të urdhërohet të marrë një vendim (të ri). Në rast se KQZ-ja përfundimisht nuk është në gjendje të miratojë vendime të tilla, mund të eksplorojnë nëpërmjet një procesi përfshirës mekanizma alternative për zgjidhjen e ngërçeve të tilla.

Avokati i Popullit krijoi për herë të parë një grup pune në lidhje me çështjet zgjedhore dhe nxiti nënpunësit civilë nën presion për të marrë pjesë në fushatë ose për të votuar në një mënyrë të caktuar që të ankohen në zyrën e tij, megjithëse vetëm disa e bënë një gjë të tillë. Sipas Avokatit të Popullit, shtetasit rrezikojnë humbjen e punës ose pasoja të tjera nëse paraqesin ose mbështesin ankesa të tilla.

KQZ-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e përputhshmërisë me Kodin Zgjedhor, duke përfshirë dhe ndalimet administrative të keqpërdorimit të burimeve materiale dhe njerëzore të shtetit, gjykimin e ankesave që kanë lidhje me to, vendosjen e sanksioneve administrative, si dhe kallëzimin e çështjeve

⁶³ Zgjedhësit mund të ankimojnë vetëm kundër përjashtimit nga regjistri i zgjedhësve dhe grupet e shoqërisë civile mund të ankimojnë vetëm kundër vendimeve që i refuzojnë atyre akreditimin si vëzhgues për zgjedhjet.

⁶⁴ Neni 145.2 parashikon, ndër të tjera: "Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim." Neni 158.4 kërkon që Kolegji Zgjedhor të caktojë një afat, një maksimum 10 ditor, për marrjen e vendimit nga KQZ-ja.

⁶⁵ Për më tepër, në dy raste në të cilat Kolegji Zgjedhor pranoi ankesat kundër refuzimit të KQZ-së për të regjistruar partitë politike ai i regjistroi vetë partitë në vend që të urdhëronte KQZ-në për të bërë një gjë të tillë.

penale pranë organeve të zbatimit të ligjit.⁶⁶ Megjithatë, kur përfaqësuesi i PS-së në KQZ paraqiti një ankim në lidhje me shkarkimin nga detyra të dy mësuesve për arsye të refuzimit për të marrë pjesë në fushatën e PD-së, kryetarja e KQZ-së refuzoi të hapë një debat në lidhje me çështjen, duke e etiketuar atë si politike.

Kuadri ligjor në lidhje me juridiksionin dhe procesin e trajtimit të ankesave administrative në lidhje me zgjedhjet është i paqartë, veçanërisht, nëse KZAZ-të (ose vetëm KQZ-ja) mund të shqyrtojnë ankesa në lidhje me fushatën dhe afatet për depozitim dhe gjykimin të tyre. Për më tepër, juridiksioni i KZAZ-ve për t'u marrë me ankesa kundër KQV-ve dhe grupeve të numërimit në lidhje me mënyrën e votimit dhe të numërimit është i paqartë.⁶⁷

KQZ-ja mund t'i kushtojë vëmendje miratimit të akteve nënligjore të cilat do të krijojnë strukturën për depozitim dhe gjykimin e ankesave që kanë të bëjnë me fushatën për komisionet zgjedhore të të gjitha niveleve, duke parashikuar juridiksion dhe afate të qarta.

XIV. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Pakicat kombëtare iu garantohen të drejta të barabarta sipas Kushtetutes, dhe këto të drejta përgjithësisht u respektojnë. Ndërsa nuk gjenden të dhëna zyrtare të besueshme mbi pakicat, vlerësohet se komunitetet më të mëdha janë ato greke dhe rome. Pakicat më të vogla përfshijnë etni maqedonase, bullgare, serbe, malazeze, boshnjake dhe vllahe.

Ligji nuk lejon përdorimin e gjuhëve të tjera në reklamën televizive të ndryshme nga gjuha shqipe, e cila ishte interpretuar nga një stacion televiziv lokal që të përfshijë spotet për fushatën zgjedhore.⁶⁸ Me përjashtim të këtij rasti, të gjithë subjektet zgjedhore zhvilluan fushatën zgjedhore lirish në gjuhën e tyre të parapëlqyer. KQZ-ja prodhoi material mbi informimin e zgjedhësve në gjuhët minoritare, i cili u shpërnda në vendndodhjet e KQV-ve, ku ishin të përqendruar etni greke, vllahe, malazeze, serbe dhe maqedonase.

Çështjet specifike të pakicave janë trajtuar gjerësisht vetëm në fushatat e pesë partive politike, të cilat fokusoheshin në komunitetet minoritare.⁶⁹ Pak parti politike përfshinë përfaqësues të pakicave në listat e tyre të kandidatëve. Komunitetet jo të favorizuara, si ato rome dhe egjiptiane, sipas raporteve u bënë më shpesh objekt i praktikave të jashtëligjshme, duke përfshirë blerjen e votës, të rënduara nga praktika e shumëpërhapur e votimit në bllok në këto komunitete. Disa drejtues të komuniteteve vendore informuan MVZ-në se një numri të anëtarëve të tyre iu mohuan e drejta e votës për shkak të mungesës së letërnjoftimeve të rregullta.

⁶⁶ Neni 21 i Kodit Zgjedhor përcakton këto kompetenca për KQZ-në.

⁶⁷ Neni 33 i Kodit Zgjedhor parashikon që KZAZ –të të regjistrojnë pretendimet nga subjektet zgjedhore në qark dhe t'i verifikojnë ato rast pas rasti. Asnjë ankesë nuk u depozitua në KZAZ-të gjatë periudhës parazgjedhore.

⁶⁸ Në kundërshtim me paragrafin 32.5 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990: “personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të [...] shpërndajnë, të kenë akses dhe të shkëmbejnë informacion në gjuhën e tyre amtare”

⁶⁹ PBDNj-ja dhe Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen u fokusuan kryesisht mbi pakicën greke, ndërsa Aleanca Maqedonase për Integrimin Evropian dhe Partia për Tolerancë Kombëtare u fokusuan mbi etninë Maqedonase dhe përkatësisht në votimin e pakicave rome dhe egjiptiane. Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane u fokusua në votën e komunitetit Vllah/Rumun.

XV. VËZHGESIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar. Vëzhguesit kanë të drejtë të vëzhgojnë të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. KQZ-ja, në një proces gjithëpërfshirës, akreditoi 8 504 vëzhgues nga 28 OJQ dhe 17 organizata të mediave, 615 vëzhgues nga nëntë organizata ndërkombëtare, 125 vëzhgues nga 15 përfaqësitë diplomatike në Shqipëri, 21 vëzhgues nga gjashtë organizata ndërkombëtare të medias dhe 32 përfaqësues nga organizmat e huaja për menaxhimin e zgjedhjeve. Për më tepër, KZAZ-të akredituan një numër të madh vëzhguesish si përfaqësues të subjekteve zgjedhore.

Vëzhguesit vendorë emërohen nga OJQ-të jopolitike. Partitë politike që konkurrojnë në mënyrë individuale dhe kandidatët e pavarur mund të caktonin nga një vëzhgues për çdo qendër votimi dhe nga një për çdo tavolinë të numërimit të votave. Koalicionet mund të caktonin tre vëzhgues për qendër votimi dhe tavolinë të numërimit të votave; sidoqoftë, një parti anëtarë e një koalicioni nuk mund të caktonte vëzhgues në mënyrë të pavarur. Vëzhguesit vendorë nuk kishin të drejtë të marrin kopje të Procesverbaleve për Mbylljen e Votimit ose të tabelës përmbledhëse të rezultateve, apo të paraqitnin ankesa që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Përfaqësuesit e mediave lokale dhe ndërkombëtare patën të drejtën e aksesit si vëzhgues në QV-të dhe VNV-të; megjithatë Kodi Zgjedhor nuk përmban detaje mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor mund të parashikojnë akreditimin e përfaqësuesve të medias si të tillë dhe jo si vëzhgues, dhe t'u garantojnë vëzhguesve vendorë të drejta të barabarta me vëzhguesit e partive politike.

Një sërë grupesh vëzhguesish vendorë raportuan mbi përgatitjet dhe ecurinë e zgjedhjeve dhe dërguan vëzhgues në terren pranë QV-ve dhe VNV-ve në të gjithë vendin në ditën e zgjedhjeve.

XVI. VOTIMI DHE NUMËRIMI

A. DITA E ZGJEDHJEVE

Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe procesi u zhvillua në mënyrë të rregullt. Gjithsesi, një përplasje e dhunshme, në mëngjes, jashtë një KQV-je në Laç, solli vdekjen e një mbështetësi të një partie dhe plagosjen e dy të tjerëve, përfshirë edhe një kandidat. Në përgjithësi dita e zgjedhjeve kaloi me qetësi, megjithëse ky rast dhe disa raste të tjera të izoluara dhune ndikuan negativisht në fillimin e zgjedhjeve.

Ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit ndërkombëtarë të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ-ja) ndoqën hapjen e 124 QV-ve, votimin në 1 297 QV, mbylljen dhe dërgimin e materialeve në 104 QV dhe numërimin e 998 kutive të votimit në 84 nga 89 VNV. Nxjerrja e rezultateve u vëzhguara në 25 VNV. Votimi u vëzhguara në 10 burgje dhe tetë spitale; 42 përqind e QV-ve të vëzhguara ishin në zona rurale dhe 58 përqind në zona urbane.

KQZ-ja shpalli pjesëmarrjen e përgjithshme prej 53.50 përqind, me ndryshime të dukshme rajonale nga 41.99 përqind në qarkun e Vlorës deri në 61.55 përqind në Kukës. KQZ-ja nuk nxorri shifrat paraprake mbi pjesëmarrjen e zgjedhësve gjatë ditës së votimit duke cituar probleme në marrjen e informacionit të plotë mbi pjesëmarrjen e zgjedhësve nga komisionet e nivelit më të ulët.

Vëzhguesit ndërkombëtar të MVZ-së vlerësuan pozitivisht procedurat e hapjes në 84 përqind të QV-ve të vëzhguara, dhe negativisht në 16 përqind, gjë e cila u konsiderua si e rëndësishme. U konstatuan

vonesa në 71 përqind të QV-ve, për arsye ku përfshihen mungesë organizimi, debate mbi procedura, mbërritja me vonesë e anëtarëve të KQV-ve apo mungesa e materialeve.⁷⁰ Në 15 raste u raportuan vonesa prej më shumë se gjysmë ore. Në 12 raste të vëzhguara, procesverbali i vulosjes nuk ishte depozituar në kutitë e fletëve të votimit përpara fillimit të votimit. Në 24 QV, persona të tjerë përveç anëtarëve të KQV-ve ndërhyjnë në procesin e hapjes së kutive. Për arsye të panjohura, një QV në ZAZ-në 88 të Sarandës (Qarku Vlorë) nuk u hap në ditën e votimit.⁷¹

Në 94 përqind të rasteve të vëzhgimit votimi ishte i rregullt dhe i mirëorganizuar, por vëzhguesit e vlerësuan atë negativisht në 6 përqind të rasteve të vëzhgimit, kryesisht për shkak të ndërhyrjes së panevojshme në proces dhe disa parregullsive procedurale. Vëzhguesit dhanë më tepër vlerësim negativ në përgjithësi në zonat rurale (10 përqind) krahasuar me zonat urbane (3 përqind). Tregues të tejmbushjes së mundshme të kutive të fletëve të votimit u vëzhguan në tre QV.⁷² Në disa raste, u vëzhguan zgjedhës të cilët fotografonin fletën e tyre të votimit brenda në dhomën e fshehtë.⁷³ Raste të votimit familjar/në grup u vëzhguan në 13 përqind të QV-të dhe më shpesh në zonat rurale.⁷⁴ Verifikimi i bojës, një nga disa prej garancive kundër votimit të shumëfishtë nuk u krye në vazhdimësi në 28 përqind të QV-ve të vëzhguara, duke qenë një prej parregullsive të veshguara më shpesh.

Votimi në emër të personave të tjerë u vëzhgua në 5 përqind të QV-ve. Në 3 përqind të QV-ve, një person u vëzhgua duke asistuar shumë zgjedhës dhe një person i cili bënte përpjekje të ndikonte tek zgjedhësit për kë të votonin. Votimi më shumë se një herë u vëzhgua në 13 QV.⁷⁵ Letërnjoftimet e zgjedhësve u kontrolluan vazhdimisht në 99 përqind të vëzhgimeve. Në përgjithësi, nuk u lejuan të votonin zgjedhësit të cilët nuk ishin në listë ose nuk kishin letërnjoftim të rregullt.

Materialet e nevojshme për informimin e zgjedhësve ishin të pranishme në shumicën e QV-ve dhe LZ-të ishin në përgjithësi të afishuara. 630 QV (44 përqind) u vlerësuan si jo lehtësisht të aksesueshme për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, që është e rëndësishme duke pasur parasysh mungesën e mundësive për votim nga shtëpia. Përgjithësisht, kushtet brenda QV-ve ofruan proces transparent. Në shtatë dhe katër përqind të QV-ve të vëzhguara, përkatësisht u konstatua mbipopullim dhe tension.

U konstatuan se vëzhguesit e partive ishin të pranishëm në 88 përqind të QV-ve të vizituara gjatë hapjes, në 89 përqind të QV-të gjatë votimit dhe në 98 përqind të VNV-të. Vëzhguesit vendorë u konstatuan të pranishëm në 35 përqind të QV-ve të vëzhguara gjatë hapjes, në 22 përqind të QV-ve gjatë votimit dhe në dy të tretat e VNV-ve të vëzhguara. Ndërsa prania e vëzhguesve rriti transparencën në përgjithësi, vëzhguesit e partive u konstatuan disa herë duke drejtuar apo duke ndërhyrë në proces. Kjo u vëzhgua në rreth 15 përqind të QV-ve të vizituara gjatë hapjes dhe mbylljes dhe në 8 përqind të vëzhgimeve të votimit. Ata që drejtonin apo ndërhyjnë në punën e KQV-ve përfaqësonin në mënyrë të barabartë koalicionet e udhëhequra nga PD-së dhe PS-së.

⁷⁰ Në QV 2547, ZAZ-ja 46 (Cërrik) në hapje të votimit nuk kishte fletë votimi. Fletët e votimit rezervë mbërritën vetëm në 12:30, ku më pas filloi votimi. Në QV 2178 në ZAZ 42 (Kavajë), mungesa e një vule vonoi hapjen deri në orën 9:45. Shumica e qendrave të votimit në ZAZ 66 (Otlak) u hapën me vonesë për shkak të mbërritjes me vonesë të listave të zgjedhësve.

⁷¹ Vëzhguesit ndërkombëtarë e MVZ-së konstatuan dorëzimin e materialit zgjedhor të papërdorur nga QV 4722 pranë VNV-të në ZAZ 88.

⁷² U vëzhguan në kutinë e votimit të QV-së 4190 në ZAZ-në 77 (Përmet), QV 1942 në ZAZ-në 37 (Tiranë), dhe QV 3192 në ZAZ-në 59 (Fier) fletë votimi të hedhura në mënyrë jo rastësore.

⁷³ Vëzhguar në Fier ZAZ 60, QV 2998 dhe Vlorë ZAZ 86, QV 4601.

⁷⁴ Vëzhguesit ndërkombëtarë e MVZ-së konstatuan se shumë raste të votimit familjar/në grup ishin në fakt votim i asistuar, i cili nuk ishte kërkuar si tillë nga votuesi apo regjistruar si i tillë nga KQV-ja, siç kërkohet me ligj.

⁷⁵ Në QV-në 2955, ZAZ 57 (Lushnje) rreth 15 raste u vëzhgua votimi më shumë se një herë

Të gjithë aktorët duhet të respektojnë ndarjen e qartë mes vëzhgimit nga ana e përfaqësuesve të partive politike dhe punës së administratës zgjedhore, dhe të respektojnë dispozitat e ligjit.

B. NUMËRIMI I VOTAVE

Mbyllja e qendrave të votimit dhe dërgimi i materialeve u vëzhgua në 93 raste dhe u vlerësua si mirë ose shumë mirë në 84 raste, dhe si keq apo shumë keq në 9 raste. Shumica e QV-ve u mbyllën në kohë dhe pati vetëm 10 raste të mbylljeve të votimit me 15 minuta vonesë; në tri raste u mbyllën me një orë vonesë. U konstatuan disa parregullsi, kryesisht për shkak të pasigurisë mbi procedurat. Në 10 raste numrat e vulave të kutive të votimit nuk u protokolluan saktësisht dhe (në 15 raste të vëzhguara) kopjet e procesverbaleve të mbylljes së votimit, jo gjithmonë iu jepeshin atyre që gëzonin të drejtën. Gjithsej, me përjashtim të vetëm nëntë rasteve të vëzhguara, materialet mbërritën në VNV-të brenda afatit të parashikuar prej tri orëve dhe të shoqëruara nga policia.

Në bazë të 84 raporteve nga VNV-të, vëzhguesit vlerësuan në të gjitha rastet materialet e marra si mirë apo shumë mirë, përveç një rasti. Procesi, përgjithësisht ishte transparent, edhe pse në disa raste mbipopullimi ndikoi veprimtarinë e VNV-ve, e vëzhguar kjo në 15 raste. Vetëm një kuti votimi u vërejt, të cilën KZAZ-ja e shpalli si ‘të parregullt’ në mbërritje.⁷⁶

Numërimi i votave filloi me vonesa të konsiderueshme për shkak të mungesës së organizimit apo pengesave të qëllimshme nga anëtarët e grupeve të numërimit, që kryesisht përfaqësonin partinë në pushtet.⁷⁷ Në një sërë VNV-sh, grupet e numërimit nuk ishin ngritur ende ose vazhdonin të trajtoheshin gjatë marrjes së kutive të fletëve të votimit në dorëzim, që shkaktoi vonesa në fillimin e numërimit.⁷⁸ Vonesa të njëpasnjëshme në procesin e numërimit u konstatuan në vendet ku grupet e numërimit pushuan gjatë (u konstatuan përafërsisht në gjysmat e VNV-ve të vëzhguara). Grupet e numërimit rrallë u vëzhguan që të punonin me turne, si e kërkon ligji.

Kushtet për numërimin ishin përgjithësisht pozitive në 84 përqind të rasteve të vëzhguara dhe u vlerësuan negativisht në 16 përqind të rasteve. Prania brenda VNV-ve e një numri të tepërt të vëzhguesve të autorizuar si dhe personave të paautorizuar, të cilët nganjëherë u vëzhguan të ndërhynin apo të drejtonin proceset, kontribuan në një vlerësim negativ.⁷⁹ Bazuar në raportet e vëzhgimit të 491 VNV-ve, gjatë gjithë numërimit, vëzhguesit konstatuan tensione mes anëtarëve të grupit të numërimit dhe vëzhguesve (100 vëzhgime) dhe mbipopullim (75 vëzhgime). Në 15 përqind të VNV-ve të vëzhguara, vëzhguesit ishin vendosur shumë larg nga tavolina e numërimit dhe një vëzhgim të mirëfilltë ishte i pamundur, duke reduktuar transparencën në përgjithësi. Në 12 përqind të vëzhgimeve, vendet e numërimit u vlerësuan nga vëzhguesit si të pamjaftueshme për numërim. Moszbatimi i ndalimit të pirjes së duhanit brenda shumicës së VNV-ve u konstatua nga shumë vëzhgues si problematik, gjë që pengoi vëzhgimin e tyre.

Planvendosja e VNV-ve duhet t’u krijojë mundësinë vëzhguesve t’i ndjekin siç duhet të gjitha aspektet e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Akses i plotë dhe i efektshëm duhet të sigurohet, por vëmendje mund t’i kushtohet kufizimit të numrit të vëzhguesve të partive politike për të ulur mbipopullimin.

⁷⁶ Një kuti votimi në QV-në VC 3289 në ZAZ 66 Otlak (Berat) u deklarua e parregullt për shkak të vulosjes e parregullt.

⁷⁷ Vëzhguesit ndërkombëtarë e MVZ-së konstatuan ndërprerje të numërimit të shkakuar nga largimi i anëtarëve të grupit të numërimit propozuar nga PD *en bloc* në VNV-në në ZAZ 37 (Tiranë) dhe ZAZ 77 (Përmet).

⁷⁸ Vëzhgimet nga VNV-të në ZAZ-të 17, 23, 31, 33, 35, 38 dhe 39. Në VNV-të në ZAZ-të 2, 78, 79 dhe 89 grupet e numërimit mbërritën vetëm pas orës 06:00 më 24 qershor.

⁷⁹ Kufijtë ligjorë të numrit të vëzhguesve të akredituar nga secili koalicion të lejuar në VNV në të njëjtën kohë nuk u zbatuan për një numër të konsiderueshëm VNV-sh.

Numërimi i votave ishte përgjithësisht i rregullt, megjithëse procesi ishte ngadalshëm; u vlerësua në përgjithësi pozitiv. Vëzhguesit ndërkombëtarë e vlerësuan pozitivisht numërimin në 92 përqind të rasteve dhe negativisht në 8 përqind të vëzhgimeve, duke treguar disa probleme. Në përgjithësi procedurat mbi vlefshmërinë e fletëve të votimit u respektuan, dhe rezultatet u hodhën vazhdimisht në tabelën përmbledhëse të rezultateve.⁸⁰ Në 32 përqind të vëzhgimeve, fleta e votimit nuk tregojnë në mënyrë të dukshme që përmbante dy vula dhe në 10 përqind të vëzhgimeve numri total i fletëve të votimit nuk u përpilua, në kundërshtim me ligjin. Vëzhguesit konstatuan në VNV-të praninë e një mesatare prej 30 përqind të anëtarëve të KZAZ-ve gra, në përputhje me kërkesat e kuotës gjinore; megjithatë gratë në përgjithësi ishin pak të përfaqësuara në grupet e numërimit dhe ndërmjet vëzhguesve.

Vetëm vëzhguesit e partive kanë të drejtë të marrin një kopje të tabelës së rezultateve të QV-së. Në rreth 10 përqind të vëzhgimeve ata nuk morën kopje edhe pse e kërkuan. Në fund të numërimit, vetëm në gjysmën e rasteve të vëzhguara nga vëzhguesit ndërkombëtarë KZAZ-të plotësuan tabelën përmbledhëse të rezultateve menjëherë, siç kërkohet, duke reduktuar transparencën.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor mund të sigurojnë që të gjithë vëzhguesit e akredituar të kenë akses të barabartë për kopjet e tabelave të rezultateve të QV-ve dhe ZAZ-ve.

KQZ-ja filloi hedhjen e rezultateve paraprake sipas QV-ve në mëngjes herët të nesërmen e zgjedhjeve. Kjo rriti transparencën dhe ndihmoi të rritej besimi në integritetin e rezultateve.

XVII. ZHVILLIMET PASZGJEDHORE

A. ZHVILLIMET PASZGJEDHORE

Të 89 KZAZ-të dorëzuan tabelat përmbledhëse të rezultateve në KQZ-në përtej afatit më 24 qershor. Po kështu, KQZ-ja miratoi tabelën përmbledhëse të rezultateve të shumicës së zonave pas afatit ligjor prej 48 orësh, pasi KQZ-ja mori të gjitha tabelat e rezultateve nga çdo zonë. Vonesat ishin kryesisht për shkak se KQZ-ja lejoi partitë politike të shqyrtonin tabelat e rezultateve dhe të negocionin çështje përpara nxjerrjes së rezultatit, në vend që partitë të paraqisnin ankesat kundër tabelës përmbledhëse të rezultateve pas miratimit të tyre, siç kërkohet nga ligji.

Me disa përjashtime, KZAZ-të hartuan tabelat përmbledhëse të rezultateve në mënyrë të kënaqshme. Në disa raste, ku KZAZ-të morën vendime të paautorizuara për të mos numëruar kutitë e rregullta të votimit për shkak të mospërputhjeve të zbuluara gjatë numërimit të votave, duke përfshirë treguesit e tejmbushjes së kutive, KQZ-ja urdhëroi numërimin e kutive të votimit.⁸¹ Ligji nuk parashikon asnjë mekanizëm për KZAZ-në të informojë KQZ-në mbi parregullsitë serioze të hasura gjatë procesit të numërimit dhe t'i kërkojë KQZ-së të shqyrtojë materialet dhe të marrë vendimin e duhur.

⁸⁰ Një mosmarrëveshje u lind në ZAZ 35 mbi 40 fletë votimi për një parti në koalicionin e PD-së të shënuara me dy shenjë. Në fund ato u pranuan si të vlefshme dhe shenja e dytë nuk u mor parasysh.

⁸¹ Në përputhje me ligjin, më 26 qershor, KQZ-ja urdhëroi numërimin e dy kutive të votimit të QV-ve 4709 dhe 4719, ZAZ 89 në Vlorë dhe më 1 korrik një kuti votimi e QV-së 3410, ZAZ 80 në Gjirokastër, në ambjentet e KQZ-së.

Nga 10 QV-të në Lezhë (ZAZ 13) KQZ-ja mori vetëm fotokopje të tabelës përmbledhëse të rezultateve.⁸² Në të gjitha 10 rastet tabelat e rezultateve shfaqën prova të qarta të manipulimit para se ato të kopjoheshin. Neni 123.3 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ-ja duhet të bazojë vendimin e saj mbi rezultatet e kopjeve origjinale të tabelave të rezultateve të QV-ve. Megjithatë, në kundërshtim me ligjin, KQZ-ja tejkaloi kompetencat e saj, dhe miratoi tabelën përmbledhëse të rezultateve për qarkun e Lezhës bazuar në rezultatet paraprake siç u transmetuan elektronikisht natën e zgjedhjeve.⁸³ Vendimi i KQZ-së u ankimua nga PD-ja.

B. ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE PAS ZGJEDHJEVE

Procesi i ankimit paszgjedhor është shumë i centralizuar. Të gjitha ankesat kundër rezultateve në çfarëdo niveli duhet të paraqiten fillimisht në KQZ-në, dhe vetëm pasi KQZ-ja ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore përkatëse. Ligjërisht, KQZ-ja e përbërë vetëm nga katër anëtarë nuk kishte kompetencën për të shqyrtuar ankesa kundër rezultateve, meqë kjo gjë kërkon një shumicë të cilësuar prej 5 votash.⁸⁴ Megjithatë, KQZ-ja pretendoi se kishte kompetencën ligjore për të vendosur në lidhje me këto ankesa dhe i shqyrtoi ato. Në të njejtën kohë, Kolegji Zgjedhor nuk ka kompetencën të ndërmarrë përgjegjësitë ligjore të KQZ-së për të gjykuar në shkallë të parë ankesat kundër rezultateve, edhe në rastet kur KQZ-ja është në pamundësi për ta bërë një gjë të tillë.⁸⁵ Megjithatë, gjykata moi këtë kompetencë dhe gjykoi ankesat paszgjedhore në shkallë të parë.

Disa subjekte zgjedhore gabimisht paraqitën ankesat kundër rezultateve në KZAZ-të gjatë numërimit ose në KQZ përpara miratimit nga ana e saj.⁸⁶ Për më tepër, një numër i madh ankimesh u kthyen nga KQZ për arsye të mangësive teknike në depozitim. Ndodhën vonesa në procesin e ankimit kur KQZ-ja nuk mori parasysh afatet ligjore duke i dhënë palëve kohë shtesë për të mbledhur prova për të mbështetur ankesat e tyre kundër rezultateve.

KQZ mori rreth 40 ankime kundër rezultateve në disa ose në të gjithë 12 zonat, shumica të depozituar nga subjektet zgjedhore të cilët pretendonin që votat e tyre ishin marrë nga partitë e tjera politike gjatë numërimit. Shumica e ankesave kundër rezultateve, veçanërisht ato të paraqitura vazhdimisht nga partitë e vogla në mënyrë mekanike u refuzuan për mungesë provash. Ankime të rëndësishme u depozituan nga PD-ja dhe PS-ja kundër rezultatit të qarkut Lezhë, nga PR-ja kundër rezultatit të qarkut Shkodër dhe nga LSI-ja kundër rezultatit të qarkut Kukës; në të tri qarqet vetëm një diferencë e ngushtë votash ndante shpërndarjen e pritshme të mandateve.

Në lidhje me zonën e Lezhës, KQZ-ja pranoi kërkesën e PD-së për rinumërim të dhjetë kutive të votimit të ZAZ-së nr.13; rinumërimi konfirmoi manipulime të rezultateve.⁸⁷ Si rezultat, KQZ-ja me iniciativën e saj urdhëroi një hetim administrativ (efektivisht një rinumërim) të 248 kutive të votimit të mbetura nga ajo zonë. PS-ja kundërshtoi vendimin e KQZ-së në këtë rast pranë Kolegjit Zgjedhor për

⁸² KQZ-ja i siguroi MVZ të OSBE/ODIHR-it akses për të vlerësuar tabelën e fotokopjuar të rezultateve nga ZAZ 13 QV 0705/1, 0708, 0708/1, 0725, 0762, 0763, 0764, 0765, 0769, dhe 0770.

⁸³ Shih vendimin e KQZ-së nr. 701, i datës 10 korrik 2013. Sipas KQZ-së, KZAZ-ja pretendoi se nuk i kishte tabelat origjinale të rezultateve.

⁸⁴ Siç parashikohet në nenin 24.1.b të Kodit Zgjedhor.

⁸⁵ Siç parashikohet në nenin 145.2 të Kodit Zgjedhor.

⁸⁶ Në shkelje të ligjit, KQZ shqyrtoi një ankim të tillë përpara se të miratonte rezultatit për zonën zgjedhore; ankesa i PBDNj-së pretendonte si të paligjshëm vendimet e KZAZ nr.89 për tërheqje nga numërimi të dy kutive të votimit për arsye të mospërputhjeve të identifikuar; KQZ-ja pranoi ankesën dhe urdhëroi KZAZ-në të numërojë kutitë e votimit. Në vendimin e KQZ-së ankesa u quajt në mënyrë të gabuar “kërkesë administrative”.

⁸⁷ Në 9 gusht, KQZ votoi të rekomandojë kallëzim penal kundër 7 komisionerëve, sekretarit dhe rreth 30 numëruesve të KZAZ nr. 13 të zonës Lezhë për falsifikim të dokumentave dhe manipulim të dhënash në lidhje me rezultatet zgjedhore si dhe pesë komisionerëve të KZAZ-së nr. 15 të të njëjtës zonë për braktisje të vendit të detyrës dhe marrje më vete të vulave të KQV-së.

arsye procedurale duke argumentuar se çdo mbledhje e KQZ-së në lidhje me një ankesë kundër rezultatit kërkon një kuorum prej 5 anëtarësh.⁸⁸ Kolegji Zgjedhor shfuqizoi vendimet e KQZ-së dhe pranoi rinumërimin e 10 kutive fillimisht në diskutim. Rinumërimi ndryshoi vetëm lehtësisht rezultatet dhe diferenca nuk ndikoi në shpërndarjen e mandateve.

Në lidhje me zonën e Shkodrës, bazuar në parregullsitë e pretenduara nga PR-ja në 79 QV-të, KQZ-ja filloi rinumërimin e të gjithë 417 kutive të votimit nga ajo zonë. Rinumërimi solli diferenca të vogla në rezultate, por nuk ndryshoi shpërndarjen e mandateve. Pas një ankese të paraqitur nga PS-ja, Kolegji Zgjedhor shfuqizoi vendimin e KQZ-së për të rinumëruar të gjithë zonën e Shkodrës, bazuar në arsyen që KQZ-ja nuk kishte kuorumin e kërkuar prej pesë anëtarësh për të marrë një vendim në këtë rast.

Në lidhje me zonën e Kukësit, KQZ-ja nuk pranoi ankimin e LSI-së pasi refuzoi të pranojë regjistrimet filmike si prova të vlefshme për të mbështetur pretendimin. Në ankim, Kolegji Zgjedhor pranoi regjistrimet filmike si prova dhe kërkesën e LSI-së për rinumërim të materialit zgjedhor nga 15 QV-të. Rinumërimi konfirmoi kryesisht rezultatet e miratuara dhe nuk ndikoi në shpërndarjen e mandateve; gjykata urdhëroi KQZ-në të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me rezultatet e zonës me shifrat e dala nga rinumërimi.⁸⁹

Një numër ankimesh nga subjekte të vogla zgjedhore kundër vendimeve të KQZ-së për refuzimin e pretendimeve të tyre nuk u pranuan nga Kolegji Zgjedhor për arsye të ndryshme.⁹⁰

Vëmendje duhet t'i kushtohet krijimit të një procesi ligjor më të efektshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi rezultatet, ku çështjet të shqyrtohen në shkallë të parë të gjyqimit dhe të parashikohet e drejta për ankim në rrugë gjyqësore. KQZ-ja duhet të shqyrtojë në themel të gjitha provat përkatëse gjatë gjyqimit të ankesave paszgjedhore. KQZ-ja mund t'i informojë më mirë subjektet zgjedhore për procesin ligjor dhe kërkesat teknike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me rezultatet.

C. SHPALLJA E REZULTATEVE

Më 2 gusht, Kolegji Zgjedhor mori përgjegjësitë ligjore të KQZ-së dhe shpërndau mandatet në të 12 zonat, si pasojë e ankimit nga ana e PS-së kundër mosmarrjes së një vendimi nga KQZ-ja për të ndarë mandatet për shkak të mungesës së kuorunit prej 5 anëtarësh⁹¹. Më pas, më 6 gusht, KQZ-ja shpalli rezultatet përfundimtare për zgjedhjet. Nga 140 deputetë të zgjedhur në parlament, 25 janë gra (18 përqind). Kjo është më pak sesa 30 përqind-shi e parashikuar në Ligjin për Barazinë Gjinore dhe

⁸⁸ Neni 22.5 i Kodit Zgjedhor parashikon që mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se katër anëtarë të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimeve, sipas nenit 24.

⁸⁹ Gjatë procesit, gjykata pranoi numërimin e dy kutive të votimit megjithëse kishte mospërputhje ndërmjet vulave me kodet e sigurisë në kuti dhe vulave me kodet e sigurisë të regjistruara në procesverbal.

⁹⁰ KQZ-ja refuzoi ankimet nga kandidatët e pavarur në Fier dhe Partisë Popullore Kristian Demokrate kundër rezultateve në Fier dhe Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar kundër rezultateve në Vlorë për mungesë provash dhe nga Partia Popullore Kristian Demokrate dhe Partia Bashkimit Popullor të Pensionistëve Shqiptarë kundër rezultateve në të 12 zonat për mosrespektim të afateve ligjore për depozitimin e ankesave.

⁹¹ Neni 145.2 i Kodit Zgjedhor nuk e lejon Kolegjin Zgjedhor të shpërndajë mandate nëse KQZ-ja nuk e bën një gjë të tillë

nënvizon nevojën për veprime të mëtejshme për të arritur një përfaqësim të balancuar gjinor në legjislaturë.⁹²

XVIII. REKOMANDIME

Këto rekomandime, ashtu siç janë paraqitur përgjatë gjithë raportit, jepen më qëllim që të përmirësojnë zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe që t'i sjellin ato plotësisht në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen marrë parasysh së bashku me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it të cilat mbeten ende për t'u trajtuar. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm që të ndihmojë autoritetet shqiptare për të përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për të ndjekur trajtimin e rekomandimeve që përmban ky raport dhe raportet e mëparshme.

A. REKOMANDIME PRIORITARE

1. Vëmendje duhet të kushtohet për të sqaruar dispozitat e Kodit Zgjedhor të cilat përkufizojnë aktet normative dhe akte të tjera që duhet të miratohen vetëm me një shumicë të cilësuar, si dhe për të harmonizuar përkufizimet e zbatueshme me Ligjin për Gjykatat Administrative. Gjithashtu, të gjitha aktet nënligjore zgjedhore dhe ndryshimet e legjislacionit zgjedhor duhet të miratohen dhe të publikohen në kohë.
2. Në mënyrë që të garantohet barazia e votës, caktimi i numrit të mandateve për zonat zgjedhore duhet të bazohet në statistikat e fundit mbi shpërndarjen e popullsisë, sikurse përcaktohet me ligj.
3. Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet për të ndaluar zëvendësimin diskrecional të anëtarëve të KZAZ-ve nga partitë politike. Për më tepër, duhet të respektohen me rigorozitet afatet ligjore për propozimin e anëtarëve të KQV-ve dhe grupeve të numërimit. Gjithashtu, mund t'i kushtohet vëmendje parashikimit të mekanizmave alternativë të emërimit, të ngjashme me ato të parashikuara për KZAZ-të, nëse partitë politike nuk i propozojnë brenda afateve të parashikuara kandidatët e tyre për KQV-të dhe grupet e numërimit.
4. Autoritetet dhe partitë politike mund të konsiderojnë marrjen e hapave më të vendosura për të siguruar që nuk ushtrohet presion mbi punonjësit e sektorit publik, aktivistët politikë si dhe persona të tjerë për të marrë pjesë në veprimtarinë e fushatës ose për të votuar në një mënyrë të caktuar. Çdo presion i tillë duhet të hetohet dhe autorët të vihen përpara drejtësisë sipas ligjit.
5. Vëmendje mund t'i kushtohet ndryshimit të nenit 84.1 të Kodit Zgjedhor, duke sqaruar më tej se çdo material i lidhur me fushatën, i përgatitur nga subjektet zgjedhore duhet të identifikohet si material propagandistik dhe të mos detyrohen transmetuesit të transmetojnë në edicionet informative materiale të tilla të regjistruara më parë.
6. Kodi Zgjedhor duhet të garantojë të drejtat e të gjitha palëve të interesuara për të paraqitur ankesa administrative kundër vendimeve dhe veprimeve të komisioneve zgjedhore, veprimeve të parregullta gjatë fushatës, parregullsive në ditën e zgjedhjeve si dhe rezultateve.

⁹² Neni 15 i Ligjit për Barazinë Gjinore në Shoqëri vendos një standart 30 përqind për përfaqësimin e të dy gjinive në parlament. Ai më tej kërkon që partitë politike të "përcaktojnë metodat dhe masat" në përputhje me këtë kërkesë dhe përcakton që ata duhet të paguajnë një gjobë deri në një të dhjetën e fondit shtetëror të alokuara për fushatën e tyre nëse ata shkelin dispozitat dhe "derisa ata të ndreqin shkeljen "

7. Kolegji Zgjedhor duhet të veprojë brenda kompetencave të tij dhe duhet ta detyrojë KQZ-në të miratojë vendimet e kërkuara. Çdo vendim i KQZ-së, i cili përmban elementë diskrecional, duhet t'i kthehet KQZ-së dhe ajo të urdhërohet të marrë një vendim (të ri). Në rast se KQZ-ja përfundimisht nuk është në gjendje të miratojë vendime të tilla, mund të eksplorohehen nëpërmjet një procesi përfshirës mekanizma alternative për zgjidhjen e ngërçeve të tilla.
8. Planvendosja e VNV-ve duhet t'u krijojë mundësinë vëzhguesve t'i ndjekin siç duhet të gjitha aspektet e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Akses i plotë dhe efikas duhet të sigurohet, por vëmendje mund t'i kushtohet kufizimit të numrit të vëzhguesve të partive politike për të ulur mbipopullimin.
9. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor mund të sigurojnë që të gjithë vëzhguesit e akredituar të kenë akses të barabartë për kopjet e tabelave të rezultateve të QV-ve dhe ZAZ-ve.

B. REKOMANDIME TE TJERA

Kuadri Ligjor

10. Rekomandohet që dispozitat penale mbi shpifjen të shfuqizohen plotësisht dhe të rregullohen nga legjislacioni civil, në mënyrë që të mos kufizohet padrejtësisht liria e shprehjes.
11. Rekomandohet që Kodi Zgjedhor të rishikohet për të trajtuar mangësitë e vëna në dukje në këtë raport dhe në raporte të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, duke përfshirë dispozita të cilat sigurojnë të drejta të barabarta për kandidatët e pavarur.

Administrata Zgjedhore

12. Duhet të sigurohet pavarësia institucionale e KQZ-së. Për këtë qëllim, palët e interesuara duhet të veprojë në përputhje me rolin që kanë në aktivitetet e KQZ-së dhe punonjësit zgjedhorë nuk duhet t'i bazojnë veprimet dhe vendimet e tyre në ndikimin e faktorëve politikë.
13. Vëmendje mund t'i kushtohet vendosjes së kuotave gjinore për KQV-të dhe grupet e numërimit në administratën zgjedhore, që të jetë në përputhje me legjislacionin tjetër të vendit.

Teknologjitë e Reja të Votimit

14. Rekomandohet që çdo zbatim i projekteve pilote SEV dhe SEN të përcaktuara me ligj, të fillojë kohë më parë sesa zgjedhjet e ardhshme, duke përfshirë përgatitje të domosdoshme të tilla si miratimi i akteve nënligjore të detajuara dhe testimi i sistemeve.

Regjistrimi i Zgjedhësve

15. Duhet të vazhdojë dhe të intensifikohet bashkëpunimi mes institucioneve qendrore dhe vendore në lidhje me masat për të zvogëluar numrin e regjistrimeve të dyshuara si të dubluara dhe numrin e zgjedhësve pa kod adrese të plotë, në mënyrë që të zgjidhen problemet e mbetura në lidhje me saktësinë e të dhënave për zgjedhësit.
16. Vëmendje mund t'i kushtohet ndërprerjes së praktikës së heqjes së zgjedhësve mbi moshën 100 vjeç nga listat e zgjedhësve dhe përfshirjes së masave jodiskriminuese për eliminimin e zgjedhësve që nuk jetojnë më.

Regjistrimi i Kandidatëve

17. Vëmendje duhet t'i kushtohet promovimit të mëtejshëm të kandidateve gra. Dispozitat ligjore ekzistuese, të cilat lejojnë KQZ-në të ndryshonte rendin e listave të kandidatëve, mund të zbatohen si dhe mund të vendosen gjithashtu edhe sanksione të tjera të mundshme në rast moszbatimi. Gjithashtu, Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet për të parashikuar pozicionim më të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të kandidateve gra në listat e partive politike.

Fushata Zgjedhore

18. Abuzimi me burimet shtetërore, përfshirë burimet njerëzore, për qëllime të fushatës zgjedhore mund të ndalohet në mënyrë më të efektshme nëpërmjet zbatimit më të mirë të ligjit dhe vënies përpara përgjegjësisë të personave që e shkelin atë.
19. Institucionet e zbatimit të ligjit mund të rrisin përpjekjet për identifikimin, hetimin dhe ngritjen e akuzave për rastet e blerjes së votave.

Financimi i Fushatës

20. Për të rritur transparencën e financimit të fushatës, rekomandohet të detyrohen pjesëmarrësit në zgjedhje t'i raportojnë rregullisht KQZ-së të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për qëllime fushate dhe t'i kërkohet KQZ-së që të publikojë raporte paraprake të financimit të fushatës përpara ditës së zgjedhjeve.

Media

21. Vëmendje mund t'i kushtohet emërimit në kohë të anëtarëve të BMM-së dhe sigurimit të një procesi gjithëpërfshirës për të gjitha organizatat jofitimprurëse mediatike, në mënyrë që të identifikohen profesionistë të përshtatshëm të fushës së medias.
22. Vëmendje mund t'i kushtohet përcaktimit të mëtejshëm të detyrave dhe përgjegjësisë të BMM-së, duke përfshirë procedura për shqyrtimin e ankesave dhe pasjen e më shumë trajnimeve për stafin monitorues të medias.
23. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe dukshmërisë së grave në fushatën zgjedhore, transmetuesit publik mund të ketë në vëmendje nxitjen aktive të pjesëmarrjes së grave duke mundësuar mbulim më të gjerë për kandidatet gra në edicionet informative, ndërsa BMM-ja mund të përfshijë një komponent gjinor në metodologjinë e tij për monitorimin e medias.

Ankimi në Rrugë Administrative dhe Gjyqësore

24. Vëmendje mund t'i kushtohet shkurtimit të afatit për gjykimin e çështjeve parazgjedhore nga Kolegji Zgjedhor në tre deri në pesë ditë (dhe jo më vonë se dita e zgjedhjeve), mundësimin të së drejtës për ankim gjyqësor, si dhe publikimit të të gjitha vendimeve të Kolegjit Zgjedhor.
25. Gjykata Kushtetuese duhet të mos refuzojë në mënyrë të papërshtatshme juridiksonin për rishikimin e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor dhe të vendimeve të parlamentit për shkeljen e garancive kushtetuese të procesit të rregullt ligjor; ligji duhet të parashikojë afate të

përsheptuara për paraqitjen dhe gjykimin e kërkesave që kanë lidhje me zgjedhjet në Gjykatën Kushtetuese.

26. KQZ-ja mund t'i kushtojë vëmendje miratimit të akteve nënligjore të cilat do të krijonin për depozitimin dhe gjykimin e ankesave që kanë të bëjnë me fushatën për komisionet zgjedhore të të gjitha niveleve, duke parashikuar juridiksion dhe afate të qarta.

Vëzhguesit Vendorë dhe Ndërkombëtarë

27. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor mund të parashikojnë akreditimin e përfaqësuesve të medias si të tillë dhe jo si vëzhgues, dhe t'u garantojnë vëzhguesve vendorë të drejta të barabarta me vëzhguesit e partive politike.

Votimi dhe Numërimi

28. Të gjithë aktorët duhet të respektojnë ndarjen e qartë mes vëzhgimit nga ana e përfaqësuesve të partive politike dhe punës së administratës zgjedhore, dhe të respektojnë dispozitat e ligjit.

Zhvillimet Paszgjedhore

29. Vëmendje duhet t'i kushtohet krijimit të një procesi ligjor më të efektshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi rezultatet, ku çështjet të shqyrtohen në shkallë të parë të gjyimit dhe të parashikohet e drejta për ankim në rrugë gjyqësore. KQZ-ja duhet të shqyrtojë në themel të gjitha provat përkatëse gjatë gjyimit të ankesave paszgjedhore. KQZ-ja mund t'i informojë më mirë subjektet zgjedhore për procesin ligjor dhe kërkesat teknike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me rezultatet.

SHTOJCË: REZULTATET PËRFUNDIMTARE

| | |
|-------------------------------------------------|-----------|
| Numri total i zgjedhësve në listat e zgjedhësve | 3,271,885 |
| Numri i zgjedhësve që votuan | 1,749,358 |
| Përqindja e zgjedhësve që votuan | 53.46 |
| Numri i fletëve të votimit të vlefshme | 1,724,779 |
| Numri i fletëve të votimit të pavlefshme | 24,279 |
| Përqindja e fletëve të votimit të pavlefshme | 1.41 |

| Subjektet Zgjedhore | | Votat | % | Mandatet | |
|-----------------------------------------|----------------------------------------------------|----------------|----------|-----------------|----|
| 1 | Lidhja për Drejtësi e Progres | LDP | 1,068 | 0.06 | 0 |
| 2 | Partia Popullore Kristian Demokratike e Shqipërisë | PPKDSH | 416 | 0.02 | 0 |
| Aleanca për Shqipërinë Europiane | | | | | |
| 3 | Partia Aleanca Popullore | AP | 8,927 | 0.52 | 0 |
| 4 | Partia Mendimi i Djathtë Liberal | MDL | 1,210 | 0.07 | 0 |
| 5 | Partia e Punës së Shqipërisë | PPSh | 955 | 0.06 | 0 |
| 6 | Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut | PBDNj | 14,722 | 0.85 | 1 |
| 7 | Ligj dhe Drejtësi | LiDr | 2,489 | 0.14 | 0 |
| 8 | Partia Unitetit Kombëtar | PUK | 513 | 0.03 | 0 |
| 9 | Partia Socialiste e Vërtetë 91 | PSV 91 | 6,135 | 0.36 | 0 |
| 10 | Partia G 99 | G99 | 2,977 | 0.17 | 0 |
| 11 | Partia Shqiptare Atdheu | PshA | 555 | 0.03 | 0 |
| 12 | Partia Pajtimit Kombëtar | PPK | 545 | 0.03 | 0 |
| 13 | Partia Komuniste e Shqipërisë | PKSh | 901 | 0.05 | 0 |
| 14 | Partia e Gjellbër | PGj | 2,084 | 0.12 | 0 |
| 15 | Partia e Punës e Shqipërisë e Riorganizuar | PPShR | 623 | 0.04 | 0 |
| 16 | Partia Bashkimi Republikan Shqiptar | PBR | 489 | 0.03 | 0 |
| 17 | Partia Rruga e Lirisë | PRRL | 808 | 0.05 | 0 |
| 18 | Aleanca Arbnore Kombëtare | AAK | 3,575 | 0.21 | 0 |
| 19 | Partia Demokracia Sociale | PDS | 11,891 | 0.69 | 0 |
| 20 | Partia Kristian Demokratike e Shqipërisë | PKDSH | 7,993 | 0.46 | 1 |
| 21 | Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane | ABDE | 728 | 0.04 | 0 |
| 22 | Partia Ambientaliste | PA | 452 | 0.03 | 0 |
| 23 | Partia e Çështjeve Shqiptare | PÇSh | 476 | 0.03 | 0 |
| 24 | Partia e Reformave Demokratike Shqiptare | PRDSH | 1,371 | 0.08 | 0 |
| 25 | Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori | PKSh 8 Nëntori | 1,352 | 0.08 | 0 |
| 26 | Lëvizja Socialiste për Integrim | LSI | 180,470 | 10.46 | 16 |
| 27 | Partia Socialpunëtore Shqiptare | PSP | 2,174 | 0.13 | 0 |
| 28 | Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet | PDIP | 4,550 | 0.26 | 0 |
| 29 | Partia Socialiste e Shqipërisë | PS | 713,407 | 41.36 | 65 |
| 30 | Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve | PMDE | 2,275 | 0.13 | 0 |
| 31 | Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve | LDSH | 508 | 0.03 | 0 |
| 32 | Partia Personat me Aftësi të Kufizuar | PPAK | 459 | 0.03 | 0 |

| | | | | | |
|----|-------------------------------------------|------------------|----------------|--------------|-----------|
| 33 | Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë | ADK | 905 | 0.05 | 0 |
| 34 | Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare | PLPSh | 316 | 0.02 | 0 |
| 35 | Partia Socialdemokrate e Shqipërisë | PSD | 10,220 | 0.59 | 0 |
| 36 | Partia Ardhmëria Shqiptare | PASHh | 2,284 | 0.13 | 0 |
| 37 | Partia Toleranca e Re e Shqipërisë | PTR e Shqipërisë | 287 | 0.02 | 0 |
| 38 | Partia Socialiste e Moderuar | PSM | 3,119 | 0.18 | 0 |
| 39 | Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim | PLDN | 1,159 | 0.07 | 0 |
| | Nëntotali | | 993,904 | 57.63 | 83 |

| Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim | | | | | |
|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------|------------------|--------------|------------|
| 40 | Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet | ADS | 1,065 | 0.06 | 0 |
| 41 | Partia Demokracia e Re Europiane | PDRE | 970 | 0.05 | 0 |
| 42 | Aleanca Demokratike | AD | 1,384 | 0.08 | 0 |
| 43 | Partia Emigracioni Shqiptar | PESh | 2,325 | 0.13 | 0 |
| 44 | Partia Demokratike | PD | 528,373 | 30.63 | 50 |
| 45 | Partia Republikane Shqiptare | PR | 52,168 | 3.02 | 3 |
| 46 | Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen | MEGA | 3,305 | 0.19 | 0 |
| 47 | Partia e të Drejtave të Mohuara | PDM | 554 | 0.03 | 0 |
| 48 | Partia Ora e Shqipërisë | POSh | 770 | 0.04 | 0 |
| 49 | Lëvizja për Zhvillim Kombëtar | LZhK | 5,429 | 0.31 | 0 |
| 50 | Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | PDIU | 44,957 | 2.61 | 4 |
| 51 | Partia Balli Kombëtar Demokrat | PBKD | 2,242 | 0.13 | 0 |
| 52 | Partia e të Drejtave të Mohuara e Re | PDM e Re | 550 | 0.03 | 0 |
| 53 | Partia Lëvizja e Legalitetit | PLL | 6,089 | 0.35 | 0 |
| 54 | Partia Demokristiane e Shqipërisë | PDK | 13,288 | 0.77 | 0 |
| 55 | Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare | PRVSH | 635 | 0.04 | 0 |
| 56 | Partia Lëvizja Shqipëria e Re | PLShR | 2,320 | 0.13 | 0 |
| 57 | Partia Balli Kombëtar | PBK | 4,868 | 0.28 | 0 |
| 58 | Bashkimi Liberal Demokrat | BLD | 2,681 | 0.16 | 0 |
| 59 | Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar | PBPPSh | 406 | 0.02 | 0 |
| 60 | Partia Konservatore | KONS | 633 | 0.04 | 0 |
| 61 | Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare | LDK | 1,190 | 0.07 | 0 |
| 62 | Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë | PAA | 2,640 | 0.15 | 0 |
| 63 | Aleanca e Maqedonasve për Integrim European | AMIE | 1,229 | 0.07 | 0 |
| 64 | Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar | PBD | 606 | 0.04 | 0 |
| | Nëntotali | | 680,677 | 39.46 | 57 |
| 65 | Aleanca Kuq e Zi | AK | 10,196 | 0.59 | 0 |
| 66 | Fryma e Re Demokratike | FRD | 29,310 | 1.70 | 0 |
| 67 | Arben Qamil Malaj | AQM | 3,044 | 0.18 | 0 |
| 68 | Dritan Vlash Prifti | DVP | 6,164 | 0.36 | 0 |
| | Totali | | 1,724,779 | 100 | 140 |

RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon Shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të respektojnë shtetin e së drejtës, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të forcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit 1992). Kjo pjesë është edhe dimensionin njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua në Samitin e Parisit në vitin 1990 si Zyra për Zgjedhje të Lira dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të zgjeruar, në të cilin të përfshiheshin të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot, organizata punëson mbi 130 vetë.

OSBE/ODIHR-i është organizmi kryesor në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në rajonin e OSBE-së janë zhvilluar në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, dhe me legjislacionin vendas. Metodologjia e vet unike siguron një vështrim në thellësi të të gjithë elementëve të procesit zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, OSBE/ODIHR-i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë: shtetin e së drejtës, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, emigracionin dhe lirinë e lëvizjes, si edhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i zbaton një numër programesh asistence të fokusuar çdo vit, duke kërkuar të zhvillojë strukturat demokratike.

Po ashtu, OSBE/ODIHR-i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të promovuar dhe për të mbrojtur **të drejtat e njeriut** dhe liritë themelore në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një sërë partnerësh me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, krijimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës në fusha tematike duke përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, monitorimin e të drejtave të njeriut dhe raportimin mbi to, si dhe garantimin e të drejtave dhe sigurisë së grave.

Për fushën e **tolerancës** dhe **mosdiskriminimit**, OSBE/ODIHR-i i jep mbështetje Shteteve pjesëmarrëse për të forcuar përgjigjet e tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të intolerancës. Veprimtaritë e OSBE/ODIHR-it në këto fusha përqendrohen në tematikat e mëposhtme: legjislacioni, trajnimi në fushat e zbatimit të ligjeve, monitorimi, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve që u jepet krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si edhe aktivitete edukative për të nxitur tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i këshillon Shtetet pjesëmarrëse mbi politikat e tyre për komunitetet **rome dhe sinti**. Zyra nxit ngritjen e kapaciteteve dhe lidhjet mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet politikëbërëse.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it në (www.osce.org/odihr)